AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

# RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në "Administrim Biznesi"**

**i**

**Institucionit të Arsimit të Lartë Kolegji Universitar "Wisdom"**


Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Prof. Dr. Ana Kapaj
2. Prof. As. Besnik Krasniqi


Shtator/2022

**RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM**

**Për Programin e studimit MSc në "Administrim Biznesi" ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë Kolegji Universitar "WISDOM"**

| Nr. | | |
|---|---|---|
| 1 | IAL aplikues: | Kolegji Universitar "WISDOM" |
| 2 | Njësia bazë që e ofron: | Departamenti i Ekonomisë |
| 3 | Emërtimi i programit të studimit: | Master i Shkencave në "Administrim Biznesi" |
| 4 | Urdhëri/VKM i licencimit: | UMASR nr. 637, dt.05.10.2018 |
| 5 | Urdhëri/VKM i riorganizimit: | - |
| 6 | Forma e regjistrimit të diplomës: | UMASR nr. 97, datë 05.02.2021 |
| 7 | Urdhëri/VBA i akreditimit të parë: | VBA nr.67, datë 18.12.2020 |
| 8 | Cikli i studimit: | Cikli i Dytë |
| 9 | Kohëzgjatja e programit të studimit: | 2 vite/4 Semestra |
| 10 | Kreditet në total (ECTS): | 120 ECTS |
| 11 | Forma e studimit: | Plotë |
| 12 | Gjuha (shqip/tjetër): | Shqip |
| 13 | Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera: | - |
| 14 | Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin): | - |
| 15 | Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin): | - |
| 16 | Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve: | 7 |
| 17 | Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit: | 8 PAE/2 PAK v.a. 2020-2021<br>6 PAE/3 PAK v.a 2021-2022 |
| 18 | Numri i studentëve: | 30 Studentë v.a. 2020-2021<br>16 Studentë v.a. 2021-2022 |
| 19 | Komente / të tjera: | - |

**PËRMBLEDHJE E VLERËSIMIT TË JASHTËM**

Kolegji Universitar Wisdom ka filluar aktivitetin e tij në në vitin 2006, bazuar në VKM nr 672 datë 27.07.2006. Ndërkohë në vitin 2008 u licensua si Shkollë e Lartë jo publike bazuar në VKM 254, datë 27.02.2008. Akreditimi i parë institucional i është dhënë këti institucioni me vendimin 47 datë 29.06.2015. Gjithashtu në vitin 2017, Bordi i Akreditimit me anë të vendimit 103 datë 10.11.2017, i dha riakreditimin këtij institucioni me statusin Kolegji Universitar Wisdom.

Programi i studimeve Master Shkencor në Administrim Biznesi, është licensuar me Urdhër nr. 637 datë 05.10.2018 të Ministrit të Arsimit, Rinisë dhe Sporteve. Ky program studimesh është akredituar për herë të parë në 2020, me vendimin nr 67 të Bordit të Akreditimit datë 18.12.2020.

Struktura dhe përmbajtja e programit të studimit përputhet me drejtimet themelore akademike të institucionit. Kolegji Universitar "Wisdom" përbëhet nga dy njësi kryesore: Fakulteti i Drejtësisë dhe Fakulteti i Shkencave Ekonomike dhe Shoqërore të cilat kanë edhe njësitë e tyre bazë. Programi studimit Master i Shkencave ne "Administrim Biznesi" ofrohet nga Departamenti Ekonomisë pranë Fakultetit të Shkencave Ekonomike dhe Shoqërore dhe si e tillë është në përputhje me fushat e drejtimet akademik të kolegjit. Përgjegjës për zbatimin e programit "Adminsitrim Biznesi" është Dekanati dhe Departamenti i Ekonomisë.

Programi i studimit është hartuar në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullativ në fuqi. Ky program është fokusuar në cilësinë e mësimdhënies, në zhvillimin e tij kryesisht me staf efektiv dhe vazhdimësinë e programit me të gjitha ndryshimet në të. Programi bazohet në Kartën e Bolonjës që përcakton ndarjen e grupimit të lëndëve në kurrikulën e programit në variantet me 120 ECTS, në përputhje me standardet dhe praktikat më të mira evropiane. Programi i studimeve ka katër semestra për një kohëzgjatje 2 vjeçare.

## Përshkrimi i procesit të vlerësimit të jashtëm

Procesi i vlerësimit të jashtëm për akreditimin e programit të studimit Master Shkencor në "Administrim Biznesi" filloi me prezantimin dhe ndarjen e punës ndërmjet ekspertëve të grupit të vlerësimit të jashtëm në lidhje me shqyrtimin e dokumentacionit të paraqitur nga IAL dhe përgatitjen e raportit të vlerësimit të jashtëm. Më pas ky grup, bazuar në dokumentacionin e vendosur në dispozicion nga ASCAL, filloi shqyrtimin e Raportit të vlerësimit të brendshëm si dhe dokumentet përkatëse në mbështetje të tij. Gjatë kësaj procedure u identifikuan dhe u listuan pyetje në lidhje me standarde dhe kritere përkatëse, të cilat do të merrnin përgjigje gjatë takimeve që do të realizoheshin në IAL.
Vizita 2 ditore në Kolegjin Universitar Wisdosm, u realizua gjatë datave 13-14.06.2022, ku Grupi i Vlerësimit të Jashtëm shoqëruar nga ekspertet e ASCAL, të caktuara për këtë program studimi, realizoi takimet e përcaktuara në axhendën e vizitës në IAL. Gjatë kësaj vizite 2-ditore Grupi i Vlerësimit të Jashtëm u takua me Dekanin e Fakultetit të Ekonomisë dhe Shkencave Shoqërore, si njësia kryesore dhe Përgjegjësen e Departamentit të Ekonomisë si njësia bazë që ofron këtë program studimesh, Grupin e Vlerësimit të Brendshëm, pedagogët dhe studentët e këtij programi studimi si dhe vizitoi zyra të caktuara të këtij institucioni dhe mjediset e tij. Gjatë këtij takimi u shqyrtuan çështje të ndryshme që lidhen me vlerësimin e programit të studimit në fjalë, duke sqaruar edhe çështje për të cilat ishin ngritur pyetje përkatëse.
Pas vizitës në IAL, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm filloi punën për të hartuar raportin e vlerësimit të jashtëm bazuar në dokumentacionin në dispozicion dhe informacionin e mbledhur gjatë takimeve dhe vizitave të realizuara në këtë Institucion. Në përfundim të këtij procesi GVJ dorëzon raportin tek Kordinatori Teknik i ASCAL. Gjatë gjithë procedurës ekspertët e vlerësimit të jashtëm janë asistuar nga Kordinatori Teknik i ASCAL, Z. Muhamed Preza.

Pasi institucioni u njoh me draft Raportin e Vlerësimit të Jashtëm dërguar me datë 12.09.2022, shprehën dakorëdësinë e tyre me draftin dhe nuk kanë komente rreth përmbajtjes së tij. Ky version është final.

**SHKALLA E PERMBUSHJES SË REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I PARË**

## I. Rekomandimet e Bordit të Akreditimit mbështetur në VBA nr.67, datë 18.12.2020 datë janë:

1. Institucioni të marrë masa për përcaktimin si titullarë lëndësh në këtë program studimi të anëtarëve të personelit akademik që i përkasin kategorisë Profesor, në përputhje me kriteret ligjore.

2. Institucioni të rishikojë kategorizimin e lendëve sipas veprimtarive formuese, me qëllim sigurimin e përputhshmërisë me VKM nr 41, dt. 24.01.2018, i ndryshuar, dhe rëndësinë konkrete të lëndëve, si dhe tu ofrojë studentëve mundësinë e përzgjedhjes së lëndëve me zgjedhje.

3. Institucioni të kryejë një studim të mirëfilltë të tregut të punës, me një metodologji të qartë lidhur me mënyrën e mbledhjes dhe analizimit të të dhënave, në të cilën të reflektojë me evidenca nevojat reale të bizneseve në Shqipëri.

4. Institucioni të hartojë raporte analitike të detajuara mbi arritjet dhe përmbushjen e objektivave të programit të studimit në rang departamenti, cilësinë e studentëve të regjistruar në këtë program studimi.

5. Institucioni të parashikojë një plan buxhet me zërat përkatës për përmbushjen e trajnimeve dhe kriteret e financimit të aktiviteteve kërkimore shkencore për zhvillimin profesional të stafit akademik të këtij programi studimi si dhe të realizojë një procedurë transparente për alokimin e fondeve për kërkimi shkencor.

6. Institucioni të përditësojë literaturën e parashikuar në sylabuset e këtij programi studimi me botime të 5 viteve të fundit, si dhe të pasurojë bibliotekën me një gamë më të gjerë botimemesh bashkëkohore në gjuhën shqipe dhe angleze.

7. Njësia e sigurimit të brendshëm të cilësisë rekomandohet të përdorë instrumenta sasiorë në mbledhjen e të dhënave dhë vlerësimet në mënyrë që njësia të mund të dalë në konkluzione të sakta, të bëjë pyetësorët pjesë të analizës periodike të mbarëvejtjes së programit të studimit dhe ti bëjë të ditura konkluzionet edhe studentëve.

## II. Plotësimi i rekomandimeve nga Institucioni

1. Në përgjigje të këtij rekomadimi KU Wisdom ka rekrutuar 3 personel akademik të kategorisë Profesor (1 Profesor dhe 2 Profesor të Asocuar). Megjithatë GVJ rekomandon

që instutucioni të vazhdojë në këtë drejtim dhe të shtojë numrin e stafit të kategorisë Profesor. (Aneks 3.06, Vizita në institucion) *Ky rekomadim plotësohet pjesërisht.*

2. Programi i studimit Master i Shkencave "Administrim Biznesi" ka të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese, sipas kategorive të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite. Sipas RVB dhe gjatë vizitës në institucion konstatohet se Lëndët bazë - përgatitje metodologjike dhe kulturë e përgjithshme zënë 10%/12 ECTS; Lëndët karakterizuese - përgatitje për disiplinen shkencore zënë 50 %/60 ECTS; Lëndët ndërdisiplinore/integruese - nëndisiplina, profile dhe grup lëndësh me zgjedhje zënë 15%/18 ECTS; Lëndë plotësuese - gjuhet e huaja, njohuri informatike, praktika mësimore zënë 10 %/12 ECTS; Detyrime përmbyllese zënë 15 % /18 ECTS. (Aneksi 3.04). *Ky rekomadim plotësohet.*

3. Hartimi i programit të studimit "Master i shkencave" është i bazuar në planin strategjik të institucionit dhe po ashtu janë konsultuar ekspertë të cilët të jashtëm dhe janë realizuar studime të tregut të punës. Sipas të dhënave, Institucioni ka realizuar në studimit të tregut të punës enkas për programin "Adminsitrim Biznesi", gjetjet e të cilit tregojnë se kërkesat e tregut për menaxherë janë shumë më të larta se sa numri i studentëve që diplomohen në universitetet publike apo private. Për të plotësuar nevojat e tregut, programi i studimit Master i Shkencave në "Administrim Biznesi" ofron lëndë mësimore që ndikojnë në formimin e përgjithshëm të studentëve si menaxherë të ardhshëm'. (Aneks 2.11) *Ky rekomadim plotësohet.*

4. Fakulteti Ekonomisë dhe Shkencave Shoqërore, si njësia kryesore dhe Departamenti Ekonomisë si njësia bazë ndjekin në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe të vazhdueshme nivelin e cilësisë së mësimdhënies në këtë program studimi. Përgjegjësinë e drejtpërdrejtë të mbarëvajtjes së programit dhe cilësisë së tij e ka Departamenti i cili bën analiza periodike dhe raporton tek Dekanati i Ekonomisë dhe pranë NJBSC-së, e përcaktuar kjo edhe në planin e punës që hartojnë njësitë përkatëse për vitin akademik. (Aneks 2.14) *Ky rekomadim plotësohet.*

5. Nga dokumentacioni i ofruar nga KU Wisdom janë paraqitur prova që IAL ka alokuar fonde që pritet të shkojnë në drejtim të kërkimit shkencor, të stafit apo studentëve. Megjithatë ajo që u vu re nga vizita në institucion është mos thithja e këtyre fondeve nga ana e stafit apo studentëve. I vetmi aktivitet me mbështetje financiare nga IAL që u bë i ditur edhe nga stafi janë konferencat e ndryshme që organizohen nga kjo IAL. *Ky rekomadim plotësohet pjesërisht.*

6. Vihet re një angazhim i stafit si dhe instancave drejtuese për rritjen e kapacitetit të bibliotekës, me libra fizikë si dhe me literature online. KU Wisdom ka edhe një fond të

dedikuar që shkon për pasurimin e bibliotekës me libra dhe literaturë, e kërkuar kjo nga stafi akademik. *Ky rekomadim plotësohet.*

7. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar, dhe më specifikisht raportet e NjSBC, kanë në bazë të tyrë vlerësime analitike dhe sasiore të tregiesve të ndryshem që synojnë të masin ecurinë e programit mësimor. (Aneks 1.15) *Ky rekomadim plotësohet*

## Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në "Administrim Biznesi"

### I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT MASTER I SHKENCAVE NË ADMINISTRIM BIZNESI

| **Standardi I.1**<br>**Institucioni i arsimit të lartë ofron program studimi "Master i shkencave"/"Master i arteve", në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni ofron program studimi "Master i shkencave"/"Master i arteve" që nuk bien ndesh me interesat kombëtare. | Kolegji Universitar "Wisdom" është Institucion Publik i Arsimit të Lartë (IAL) me financim privat dhe burime të tjera të ligjshme. Kolegji universitar "Wisdom" ofron programin e studimit te ciklit te dyte Master i Shkencave Administrim Biznesi. Synimi i Kolegjit Wisdom është të ofrojë mundësi në zhvillim të dijeve dhe shkencës, inovacionit dhe të profesioneve të ligjshme. Wisdom ka për mision "..edukimin profesional dhe kërkimin shkencor me qëllim krijimin e specialistëve të rinj, në përputhje më prioritetet e zhvillimit të vendit….të kontribuojë në zhvillimin ekonomik, social e kulturor në nivel rajonal e kombëtar"<br>Veprimtaria mësimore në Wisdom, zhvillohet në përputhje me nevojat e zhvillimit ekonomik dhe social të vendit. Ajo synon t'u paraprijë dhe t'u japë përgjigjet sfidave të zhvillimit dhe të integrimit të vendit në strukturat evropiane, shfrytëzimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore, rritjes së prodhimit vendas dhe njëkohësisht zgjerimit të llojshmërisë dhe të vëllimit së eksporteve, rritjes së konkurrencës, etj.,<br>Programi i studimit Master Shkencor Administrim Biznesi plotëson kriteret sa i takon rëndësisë së programit për nevojat e ekonomisë, organizimit dhe administrimit të tij nga kompetencat që ai përcjell, si dhe sa i takon mësimdhënies, mësimnxënies. Studentet e këtij programi fitojnë njohuri të menaxhimit, ndaj përshtaten më së miri me kërkesat e tregut në këtë fushë. Ata mund të punësohen si:<br>- menaxherë në ndërmarrjet dhe biznese të ndryshme;<br>- në agjenci të ndryshme shtetërore;<br>- në institucionet e sistemit bankar dhe ato të mikrofinancës;<br>- në institucione politikbërëse në nivel qëndror dhe atë lokal;<br>- në institucione apo agjenci të tjera publike ose private;<br>- në sektorin privat, banka, institucione të administratës qendrore dhe vendore etj.<br>Plotësimi i këtij kriteri sigurohet gjithashtu edhe nga respektimi i Legjislacionit në fuqi, në mënyrë specifike i ligjit Nr. 80/2015 datë 22.7.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" dhe rregulloreve të tjera të brendshme.<br><br>*(Aneks 1.01 Statut i Kolegjit Wisdom; Aneksi 1.03 Plani Strategjik i Zhvillimit 2018 – 2023 i Kolegjit Universitar "Wisdom")* |
| **Kriteri 2.** Programi i studimit "Master i shkencave"/"Master i arteve" synon ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare. | Kolegji Universitar "WISDOM" ka hartuar programin e studimit bazuar në synimet staretgjike të tij dhe mbi nje pervoje shume vjeqare institucionale. Programi i studimit Administrim Biznesi realizohet në perputhje me ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombetare. Në dokumentet strategjik shprihësht janë të evidentuara këto vlera dhe qëllim të Kolegjit |

| | |
|---|---|
| | Wisdom sic janë evidentuar edhe në RVV:<br>• Nje qender te kerkimit shkencor baze dhe te zbatuar, ne sherbim te komunitetit duke theksuar qe zhvillimi i kerkimit shkencor, dhe kultivimi i tij siguron vazhdimesine dhe nje te ardhme me te mire per brezat e ardhshem.<br>• Nje qender per zhvillimin e dijes ne shoqerine shqiptare, duke kontribuar ne formimit akademik te studenteve universitare dhe pasuniversitar<br>• Nje qender e mesimit shume funksional, ku traditat me te mira morale, kulturore, historike, arsimore dhe shkencore te vendit si dhe arritjet me te mira boterore dhe ato europiane, jane baza e mesimdhenies, duke i sherbyer dijes se shoqerise shqiptare, por edhe ne perputhshmeri me kerkesat e tregut te punes.<br>Bazuar në vizitën e komisionit të jashtëm të vlerësimit aktiviteti shkencor nuk është i zvhilluar në shkallën që pretendohet. Stafi akademik i Kolegjit 'Wisdom" ka një numër të limituar të punimeve shkencore në revista me faktor impakti<br><br>*(Aneksi 1.02 Statuti i Kolegjit Universitar "Wisdom"; Aneksi 1.03 Plani Strategjik i Zhvillimit 2018-2023 i Kolegjit Universitar "Wisdom"; RVB; Vizita në institucion)* |
| **Kriteri 3.** Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë. | Programi Master Shkencor në "Administrim Biznesi" mbështet zhvillimine aftësive të specializuara të studentëve dhe përbën një mundësi për të përforcuar lidhjen e studentëve me një sektor apo profesion në për fundim të këtij cikli studimi. Programi "Administrim Biznesi" ofrohet në përputhje me Misionin e përcaktuar në Statut të Kolegjit "Wisdom" ku thuhet se kolegji ofron kushte dhe ambijente të përshtatshme, duke aplikaur metodova të avansuar të mësimdhënies dhe program në përputhje me fushat e përcaktuara të studimit. Programi "Administrim Biznesi" hyn në kuadër të fushave Drejtësi, Ekonomi dhe Shkenca Sociale, që janë përcaktuar në Statut të KU "Wisdom" Prandaj mund të themi se Programi i studimit Master i shekencave në "Administrim Biznesi" eshte hartuar ne perputhje me qëllimet dhe misionin e deklaruar të Kolegjit WISDOM. Referuar Statutit te Kolegjit Universitar "WISDOM", Neni 4, qellimi dhe rnisioni i Kolegjit Universitar "WISDOM" janë. Edhe gjatë vizitës me përgjegjësit e institucionit është konfirmuar se stafi menaxhues e ka të artë misionin dhe rolin e progrmit MSc në Administrim Biznesi që buron nga ky mision. Programi i studimit është po ashtu në përputhje me Karten e Bolonjës në bazë të të cilës janë të orgnizuara studimet në KU Wisdom.<br>Sa i përket cilësësi së mësimit, vihet re aplikimi i metodoave të avansuara të mësimdhënies dhe mësimnxënies. Syllabuset janë moderne dhe të krahasueshme me progrmaet evropiane të ngjashme. KU Wisdom mund të bëjë më shumë sa i përket ndërkombëtarizimit. Iniciativat si ato me unviersitete italiane duhet të jetësohen dhe zbatohen.<br><br>*(Aneksi 1.01 Statuti i Kolegjit Universitar "Wisdom"; Aneksi 1.02 Rregullore e Kolegjit Universitar "Wisdom"; Aneksi 1.03 Plani Strategjik i Zhvillimit 2018-2023 i Kolegjit Universitar Wisdom; Aneksi 3.01 Rregullore e Programit te studimit Master i Shkencave ne "Administrim Biznesi"; RVB, Vizita në institucion* |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 4.** Programi i studimit "Master i shkencave"/"Master i arteve" hartohet dhe ofrohet në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar. | Programi i studimit "Master i shkencave" hartohet dhe ofrohet në përputhje me nevojat e tregut të punës dhe si i tillë dhe kontiboun në zhvillimin ekonomik lokal dhe kombëtar. Hartimi i këtij programi të studimit është i bazuar në planin strategjik të institucionit dhe po ashtu janë konsultuar eksperte te cilet të jashtëm dhe janë realizuar studime të tregut të punës. Sipas të dhënave, Institucioni ka realizuar në studimit të tregut të punës enkas për programin "Adminsitrim Biznesi", gjetjet e të cilit tregojnë se kerkesat e tregut per menaxherë jane shume me te larta se sa numri i studenteve qe diplomohen ne universitetet publike apo private. Per te plotesuar nevojat e tregut, programi i studimit Master i Shkencave ne "Administrim Biznesi" ofron lende mesimore qe ndikojne ne formimin e pergjithshem të studentëve si menaxherë të ardhshëm'.<br><br>*(Aneks 1.03 Plani Strategjik i Zhvillimit 2018-2023 i Kolegjit Universitar "Wisdom"; Aneks 2.09 Studimi i Tregut i programit te studimeve Master i Shkencave ne "Administrim Biznesi"; Aneks 3.05 Veprimtaria formuese e programit)* |
| **Kriteri 5.** Programi i studimit "Master i shkencave"/"Master i arteve" krijon baza të qëndrueshme njohurish për studime të thelluara të ciklit të tretë, duke përfshirë aftësimin e thelluar profesional e shkencor | Bazuar në përmbajtjen e programit, syllabuset dhe strukturën e tij evidentojmë para së gjithash përmbushjen e standardit shkencor për një program të nivelit të dytë. Niveli dhe struktura e tij është e përshtatshme dhe ka përmbajtjen shkencore ku dominojnë transmetimi i njohurive shkencore në fushën e biznesit dhe financës. Po ashtu ekziston një gërshetim i dijeve teorike me ato aplikative dhe profesionale.<br><br>*(Aneksi 3.01 Rregullore e programit te studimit Master i Shkencave ne "Administrim Biznesi"; Aneks 3.11 programet mesimore syllabuset)* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi I.2**<br>**Programi i studimit MSH/MA është në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni përcakton qartë se programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit. | Programi i studimit "Administrim Biznesi" është hartuar dhe ofrohet nga departamenti i Ekonomisë. Bazuar në Statutin i Kolegjit Universitar "Wisdom" si dhe në Planin Strategjik të Zhvillimit të Kolegjit Universitar "Wisdom", përcaktohen qartë objektivat e programit të studimit MSc. në Administrim Biznesi si një program që synon përgaditjen e specilistëve të lartë në fushën ekonomike/menaxheriale. Ky specilizimi arrihet nëpërmjet harmonizimit të formimit teorik me aftësimin praktik. Referuar dokumentacionit të mësipërm, RVB-së dhe takimeve në institucion, GVJ gjykon që ky program përputhet plotësisht me Strategjinë e Zhvillimit të Institucionit, dhe se fusha e veprimtarise se kolegjit ne teresi dhe e njesise baze qe ofron kete program studimi jane ne perputhje te plote. Plani Strategjik i Zhvillimit dhe njesite baze e kryesore kane perputhshmesi te veprimtarise se programit me ate te kolegjit ne teresi: formimi i specialisteve te fushes se ekonomise, profili Administrim biznesi. |

| | |
|---|---|
| | *(Aneksi 1.01 Statuti i Kolegjit Universitar "Wisdom"; Aneksi 1.03 Plani Strategjik i Zhvillimit të Kolegjit Universitar "Wisdom", 2018-2023; Aneksi 1.14 Strategjia për Kërkimin Shkencor, Projektet, Partneritetin dhe Mobilitetin Ndërkombetar; Aneksi 3.01 Rregullore e Programit të studimit Master i Shkencave në "Administrim Biznesi"; RVB; Vizita në Institucion)* |
| **Kriteri 2.** Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimet prioritare akademike të tij dhe demonstrojnë se programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit. | Statuti dhe rregullorja e Kolegjit Universitar "Wisdom" përcaktojnë shtyllat kryesore ku mbështetet e gjithë veprimtaria akademike dhe shkencore e institucionit. Statuti dhe rregulloret e institucionit përcaktojnë qarte drejtimet dhe prioritetet akademike në fushën ku vepron institucioni si dhe te aktiviteteve të kerkimit shkencor, veprimtarive krijuese dhe profesionale. Kolegji Universitar "Wisdom" ofron programe te formimit te vazhduar ne funksion te rritjes dhe kualifikimit te aftesive profesionale, ne perputhje me legjislacionin ne fuqi.<br><br>*(Aneksi 1.01 Statuti i Kolegjit Universitar "Wisdom"; Aneksi 1.02 Rregullore e Kolegjit Universitar "Wisdom"; Aneksi 1.03 Plani Strategjik i Zhvillimit te Kolegjit Universitar "Wisdom", 2018-2023)* |
| **Kriteri 3.** Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programit të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimet akademike të institucionit. | GVJ konstaton se struktura dhe përmbajtja e programit të studimit përputhet plotësisht me drejtimet themelore akademike të institucionit. Sipas të dhënave dhe organogramit Kolegji Universitar "Wisdom" përbehet nga dy njesi kryesore: Fakulteti i Drejtesise dhe Fakulteti i Shkencave Ekonomike dhe Shoqerore të cilat kanë edhe njësitë e tyre bazë. Programi studimit Master i Shkencave ne "Administrim Biznesi" ofrohet nga Departamenti Ekonomise prane Fakultetit të Shkencave Ekonomike dhe Shoqërore dhe si e tillë është në përputhje me fushat e drejtimet akademik të kolegjit. Përgjegjës për zbatimin e programit "Adminsitrim Biznesi" është Dekanati dhe Departamenti i Ekonomise.<br><br>*(Aneksi 1.01 Statuti i Kolegjit Universitar "Wisdom"; Aneksi 1.02 Rregullore e Kolegjit Universitar "Wisdom"; Aneksi 2.08 Rregullore e Departamentit të Ekonomisë; Aneksi 3.01 Rregullore e programit te studimit Master i Shkencave në "Administrim Biznesi")* |
| **Kriteri 4.** Programi i studimit "Master i shkencave"/"Master i arteve" hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe trendet globale të zhvillimit | Programi i studimit Master i shkencave në "Adminsitrim Biznesi" është hartuar duke përshtatur kurrikulën me standardet më të mira evropiane dhe duke ju përgjigjur kërkesave të tregut të punës. Programi i studimit Master i Shkencave ne "Administrim Biznesi" ( e reflektuar edhe në kurrikulë dhe përmbajtje të lëndëve) eshte hartuar perputhje me strategjine kombetare te zhvillimit, interesat kombetare dhe trendet gobale te zhvillimit. Për shembull, lënda " Enterprise and Innovaiton", "Mangerial Economics", Business Ethics etj jane të ngjashme me praktikat e universiteteve evropiane. Edhe lendet e tjera e bejne programin të krhasueshme me programet e tjera evropiane.<br><br>*(Aneksi 2.11 Studimi Periodik i Tregut i programit te studimit Master i Shkencave ne "Administrim Biznesi"; Aneksi 3.01 Rregullore e programit te studimit Master i Shkencave ne "Administrim Biznesi")* |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |

| | | | | X |
|---|---|---|---|---|

| Standardi I.3<br>Programi i studimit "Master i shkencave"/"Master i arteve" synon të plotësojë nevojat e tregut të punës dhe ofrohet në përputhje me kërkesat e tij. | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Programi i studimit "Master i shkencave"/"Master i arteve" ka objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në atë program, të cilët përfshijnë njohuritë e thelluara shkencore, aftësitë dhe kompetencat profesionale, që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen ato dhe me kërkesat e tregut të punës. | Programi i studimit Master Shkencor në "Adminsitrim Biznesi", ka të përcaktuara qartë objektivat e tij në formimi i specialisteve ne fushen e administrimit te biznesit, duke i vene theksin në njohuritë dhe kompetencat qe lidhen me fushën e administrimit të biznesit. Në arritjen e ketij objektivi kolegji gërsheton aspektin shkencor dhe aspektin aplikativ e profesional. Fokusi i kolegjit është në dhenien e dijeve dhe aftesive profesionale si dhe formimin praktik te studenteve deri ne perfundim te programit te studimit, dhe jane ne perputhje me studimet e nivelit 7 dhe mundesojne qe studentet te formohen konform kerkesave te tregut te punes.<br><br>*(Aneksi 2.11 Studimi Periodik i Tregut i programit te studimit Master Shkencave ne "Administrim Biznesi "; Aneksi 3.01 Rregullore e programit te studimit Master Shkencave ne "Administrim Biznesi"; Aneks 3.11 programet mesimore syllabuset; Vizita në Institucion)* |
| **Kriteri 2.** Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programin e studimit që ofron përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës. | Kolegji "Wisdom" dhe njësit e tij bazë kryejnë studime të rregullta mbi tregun e punës mbi të cilat mbështet vendimarrja lidhur me programet e ofruara të studimit. Zyra e Burimeve Njerezore, Karrieres dhe Jetes Studentore, ka realizuar studime periodike të tregut të punës. Kjo zyre ofron edhe këshillime karriere për studentët dhe shërben si urë ndëlidhëse me punëdhënësit, mban të dhënat mbi të diplomuarit si dhe punësimin e tyre. Kjo bazë e të dhënave pastaj sherben për vendimmarrje të informuar lidhur me programin e studimeve. Po ashtu, porgrami i lëndës Professional Practice, obligon studentët të kryjnë 240 orë praktike krahas atyre individuale dhe si e tillë ndihmon studentët të kutpojnë aplikimin praktik të koncpeteve teorike. Pë më tepër, KU Wisdom ka marrëveshje të bashkëpunimit me institucione brenda dhe jashtë vendit, ku mundesohet kryerja e praktikes mesimore.<br><br>*(Aneksi 1.09 Rregullore e Zyres se Burimeve Njerezore, Keshillimit te Karrieres dhe Jetes Studentore; Aneksi 2.11 Studimi Periodik i Tregut programit te studimit Master Shkencave ne "Administrim Biznesi"; Aneksi 4.03 Relacion tabelat e Marreveshjeve te bashkepunimit me institucione; Aneksi 2.24 Te dhena Tabelorepermbledhese per punesimin real te studenteve; Vizita në institucion)* |
| **Kriteri 3.** Objektivat formues, struktura dhe përmbajtja e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit garantojnë përftimin e dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave që i përgjigjen nevojave të tregut dhe lehtësojnë punësimin e studentëve. | Në tërësi ky program bazohet në objektiva formuese të qarta dhe strukturë të përshtatshme që janë në funksion të formimit profesional të studentëve, dijeve dhe aftësive të studentëve në tregun e punës.<br><br>*(Aneks 3.04 Planet Mesimore; Aneks 3.05 Veprimtaria formuese e programit; Aneks 3.11 programet mesimore syllabuset; Vizita në Institucion)* |
| **Kriteri 4.** Programi i studimit përafrohet me programe studimi të | Programet jane te organizuara dhe te pershtatura ne perputhje me lesgjislacionin në fuqi si dhe udhezimet ne fuqi të Republikës së Shqipërisë, |

| | |
|---|---|
| ngjashme të ofruara nga institucione ndërkombëtare me qëllim lehtësimin e transferimit të studimeve apo punësimin e studentëve në të ardhmen në tregun ndërkombëtar. | te cilat i krijojne mundesi dhe akses studenteve te transferojne studimet e tyre ne institucione nderkombetare duke mundësuar transferime në universitete tjera vendase ose të huaja, publike ose jopublike, dhe lejon transferimin e studentëve të tij në shkolla të tjera. Kjo ju mundson studentëve vazhdimin e studimeve në universitet tjera si dhe punesimin ne tregun nderkombetar. Struktura e programit e bazuar ne kreditet (ECTS) mundeson levizjen e studenteve ne programe te ngjashme, duke promovuar mobilitet nderkombetar brenda dhe jashte vendit. Nga vizita në institucion, morëm informacion për referencën e bashkëpunimit të Kolegjit "Wisdom" me unversitete të tjera të huaja në kuadër të programit Erasmus që ka mundësuar mobilitetin e stafit dhe studentëve.<br><br>*(Aneksi 3.01 Rregullore e programit te studimit Master Shkencave "Administrim Biznesi"; Aneksi 3.11 Suplementi i diplomes; Aneksi 3.08 Programet mesimore (syllabuset); Aneks 4.03 Relacion per Trajnimet Nderkombetare te studenteve; Aneks 4.30 Mobility Agreement Staff Mobility for Teching Kontrate midis Dr Rinaldo Mucadhe Erasmus +Shkurt 2022; Vizita në institucion)* |
| **Kriteri 5.** Programi i studimit hartohet në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara, mbështetet në përvojën disavjeçare të institucionit dhe praktikat e mira të vendeve evropiane. | Programi i studimit është hartuar në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullativ në fuqi. Hartimi është fokusuar në cilësinë e mësimdhënies, në zhvillimin e tij kryesisht me staf efektiv dhe vazhdimësinë e programit me të gjitha ndryshimet në të. Programi bazohet në Kartën e Bolonjës që përcakton ndarjen e grupimit të lëndëve në kurrikulën e programit në variantet me 120 ECTS, në përputhje me standardet dhe praktikat më të mira evropiane.<br>*(Aneksi 3.01 Rregullore e programit te studimit Master Shkencave "Administrim Biznesi"; Aneksi 3.11 Suplementi i diplomes; Aneksi 3.08 Programet mesimore (syllabuset);Aneksi 3 Nen/Dosja C, Dosja eplate didaktike)* |
| **Kriteri 6.** Programi i studimit "Master i shkencave"/"Master i arteve" përfshin aftësimin profesional në praktika profesionale të përputhura me qëllimin dhe objektivat e programit, si dhe në direktiva ndërkombëtare për profesionet e rregulluara. | Programi i studimit Master Shkencave ne "Administrim Biznesi" gërsheton aftësim teorik, profesional dhe shkencor. Aftesimi profesional i studenteve realizohet permes praktikes mesimore gjate periudhes 15 javore në fund të semestrit te dyte, të vitit të dytë. Kolegji ka edhe marrëveshje me institucione vendore publike dhe private që mundësojnë kryerjen e praktikes mesimore . Kolegji Universitar "Wisdom" ka 14 marreveshje bashkepunimi dedikuar programit te studimit, binjakezime dhe memorandum ne nivel institucional, me universitete, akademi, kompani private, institucione shteterore, OJF dhe shoqata te ndryshme.<br><br>*(Aneksi 3.01 Rregullore e programit te studimit Master Shkencave "Administrim Biznesi"; Aneksi 4.03 Raporti per zbatimin e marreveshjeve te bashkepunimit për programin Master i Shkencave ne "Administrim Biznesi" 2019-2022; Aneksi 3.12 Regul/ore e Praktikes mesimore profesionale per programin Master i Shkencave ne "Administrim Biznesi "; Aneksi 3.12.1 Udhezues i praktikave (bashke/idhur model/ template i dosjes se plate te dokumentacionit); Aneksi 3.12.2 Vendim "Per percaktimin e institucioneve dhe tutoreve per mbikqyrjen e praktikes profesionale per programin e studimit per vitin 2021-2022; Aneksi 3.12.3 Relacion per* |

| | |
|---|---|
| | *praktikat e studenteve neprogramin e ciklit te dyte Master i Shkencave ne "Administrim Biznesi ")* |
| **Kriteri 7.** Në programin e studimit "Master i shkencave"/"Master i arteve", duhet të përfshihen elemente të mësimdhënies, module, lëndë ose i gjithë programi në gjuhë të huaj me qëllim thithjen e studentëve të huaj, rritjen e mobilitetit në kuadër të kërkimit shkencor dhe ndërkombëtarizimin e institucionit. | Programi i studimit Master Shkencor në "Adminsitrim Biznesi" ofrohet vetëm në gjuhën shqipe. Gjatë vizitës janë evidentuar përpjekje të insttiucionit për bashkëpunim me universitete italiane për të ofruar program edhe në gjuhë tjera, por janë në fazën e diskutimeve.<br>(*RVB, Vizita në Insttiucion)* |
| **Kriteri 8.** Për programin studimit "Master i shkencave"/"Master i arteve", institucioni përgatit, ruan dhe arkivon të gjithë dokumentacionin dhe aktivitetin e zhvilluar edhe në gjuhën angleze | Gjatë viyitës në institucion *nuk u ofruan dokementa mbështetës që vërtetonin se Kolegji Universitar "Wisdom" pergatit, ruan apo arkivon dokumentacionin si dhe aktivitetin e zhvilluar edhe ne gjuhen angleze.* Ndërkohë që programi i studimeve Master i Shkencave ne "Administrim Biznesi" vendos ne dispozicion te studenteve gjithe syllabuset në gjuhë shqipe dhe angleze.<br><br>*(RVB, Vizita ne institucion)* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | X | |

**Standardi I.4**
**Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.**

| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
|---|---|
| **Kriteri 1.** Institucioni demonstron se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë. | Kolegji universitar "Wisdom" në përgjithësi ka pervojen, kapacitetet dhe burimet e duhura per të ofruar programin Master i Shkencave në "Administrim Biznesi". Fakulteti i Shkencave Ekonomike dhe Shoqerore, përkatësisht Departamenti i Ekonomise ka numër të mjaftueshëm të personelit akademik dhe mbështetës për nevojat e ketij programi. Sipas të dhënave të prezantuara në RVB dhe dokumentacionit përcjellës për këtë program studimi personeli akademik i angazhuar eshte kryesisht Personel Akademik Efektiv. Raporti rezulton te jete 1 personel akademik efektiv me titullin Prof. Dr, 1 Prof. As., 4 Dr dhe 4 Msc, ndwrsa personel me kontratw rezulton tw jetw 1 Prof. Dr., 1 Dr., 1 Msc. Stafi akademik ka marrë pjesë në konferenca shkencore dhe programe të shkëmbimit të stafit sic është programi Erasmus, por *sfidë mbetet publikimi në revista shkencore të indeksuara në platforma prestigjioze ndërkombëtare.* Infrastruktura e fizike është e majftueshme.<br><br>*(Aneksi 1.02 Rregullore e Kolegjit Universitar "Wisdom" Aneksi 2.14 Analiza vjetore e Departamentit te Ekonomise; Aneksi 2.21 Te dhena tabelore per personelin akademik ne programin e studimit Master i Shkencave ne "Administrim Biznesi"; Aneksi 2.48 Planimetria dhe Infrastruktura e re e KU Wisdom; Aneksi 2.40 CV e stafit akademik te programit te studimit & CV e stafit ndihmes akademik)* |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 2.** Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. | Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit është relativisht në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore përgjegjëse për këtë program studimi që është Fakulteti i Ekonomisë dhe Shkencave Shoqërore. Kjo perputhshmeri reflektohet edhe në rregulloret e njesise baze, dhe poashtu është në harmoni me emertimin e programit te studimit. Edhe pse ka përpjekje për të avansuar kërkimin sheknc or, kapacitete kërkimore të stafit mbeten të limituara, me një numër ët vogël të publikimeve shekencore. Kolegji unviersitar WISDOM synon qe kerkimi te behet nje nga karakteristikat dalluese te identitetit te tij.<br><br>*(Aneks 2.06 Rregullore e Fakultetit te Shkencave Ekonomike dhe Shoqerore; Kërkimi në platforma elektronike të publikimeve të stafit akademik)* |
| **Kriteri 3.** Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/ kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje | Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit është plotësisht në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë përgjegjëse për këtë program studimi që është Departamenti i Ekonomisë që mbulon këtë program, i cili që në emërtim është i njëjtë me objektivin e këtij programi dhe që gjithashtu ka pjesën me të madhe të stafit të programit nga fusha përkatëse.<br><br>*(Aneksi 2.10 Rregullore e Departamentit te Ekonomise; Aneks 3.01 Rregullore e Programit te Studimi Master Shkencave ne "Administrim Biznesi"; Aneks 3.17 Udhëzuesi didaktik i Programit te Studimit Master i Shkencave ne "Administrim Biznesi")* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | X | |

| **Standardi I.5**<br>**Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre. | Referuar RVB-së si dhe informacionit të marrë gjatë vizitës në institucion, konstatojme se Fakulteti i Shkencave Ekonomike dhe Shoqërore në Kolegjin Wisdom në organigramën e vet ka 3 departamente, apo Njësi bazë: Departamenti i Ekonomisë, Departamenti i Psikologjisë, dhe NJKSHMJ. Për këtë program studimi, Master i Shkencave në Administrim Biznesi, Njësia bazë përgjegjëse është Deparamenti i ekonomisë. Hartimi, mbikqyrja dhe mbarevajtja e programit te studimit Master Shkencave ne "Administrim Biznesi" sigurohet nga nje marredhenie e frytshme bashkepunimi brenda Kolegjit Universitar "Wisdom", nepermjet ndarjes se detyrave mes fakultetit dhe departamentit pergjegjes, i cili ofron dhe personelin akademik. Realizimi i programit mesimor mbulohet kryesisht me personelin akademik te vete njesise baze dhe mbështet edhe nga deaprtamentet tjera për lëndë të prëgjithshme. |

| | |
|---|---|
| | *(Aneksi 2.13.1 Plani Strategjik iprogramit te studimit 2021 – 2023; Aneksi 2.13 Programi i veprimtarive kryesore te Departamentit te Ekonomise Aneksi 2.14 Analiza vjetore e Departamentit te Ekonomise, VA 2020-2021)* |
| **Kriteri 2.** Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj. | Nga shqyrtimi i RVV dhe dokumeteve të tjera rezulton se Kolegji Universitar "Wisdom", ka nënshkruar një numër të konsiderueshëm marrëveshjesh me institucione të arsimit të lartë jashtë vendit dhe brenda vendit, si dhe me një numër subjektesh ekonomike private. Në përbërje të tij, Kolegji Universitar "Wisdom", nepërmjet të Njesisë së Kerkimit Shkencor dhe Marredhenieve me Jashte (NJKSHMJ) vendos marredhenie afatgjata dhe te qendrueshme bashkepunimi. Sipas të dhënave Kolegji Universitar "Wisdom" ka 98 bashkepunime per permbushjen e detyrimit te praktikes mesimore te studenteve, nga te cilat 14 jane specifikishit ne funksion te ketij programi.<br><br>*(Aneksi 4.02 Raport vjetor i veprimtarise se Njesise se kerkimit Shkencor dhe Marredhenieve me Jqsh,të;·yiti akademik 2020-2021; Aneksi 4.03 Raport (per zbatimin. e marreveshjeve te bashkepunimit per programin Maser-i Shkencave ne "Administrim Biznesi" 2019-2022; Aneksi 2.14 Analiza vjetore e Departamentit te Ekonomise, VA 2020-2021; Aneksi 4.05 Tabelat permbledhese dhe Marreveshjet e bashkepunimit me institucione).* |
| **Kriteri 3.** Për realizmin e programit të studimit "Master i shkencave"/"Master i arteve", institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani, të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj. | Në vazhden e aktiviteteve të përshkruara tek Kriteri 2 i këtij stndardi, pergjegjesi i Departamentit te Ekonomise, cakton pedagoget pergjegjes per ndjekjen e zbatimit te praktikes. Sipas RVB dhe vizitës në insttiucion bashkepunimi me nje institucion/kompani formatizohet mbi bazen e marreveshjeve standarte. Progresi i punes se studentit monitorohet nga institucioni prites dhe pedagoget pergjegjes. Ne fund, studenti paraqet nje relacion dhe prezanton detyrat e kryera/permbushura. Studentet gjithashtu pajisen me Udhezuesin e Praktikave, perpara fillimit te praktikes.<br><br>*(Aneksi 4.05 Tabelat permbledhese dhe Marreveshjet e bashkepunimit me institucione; Aneksi 4.03 Raporti per zbatimin e marreveshjeve te bashkepunimit per programin Master i Shkencave ne "Administrim Biznesi" 2019-2022; Aneksi 3.12 Rregullore e Praktikes mesimore profesionale per programin Master i Shkencave ne "Administrim Biznesi"; Aneksi 3.12.1 Udhezues i praktikave (bashkelidhur model/template i dosjes se plote te dokumentacionit); Aneksi 3.11. Programi i lendes "Praktike Mesimore"; Aneksi 3.12.2 "Vendim për përcaktimin e institucioneve dhe tutoreve per mbikqyrjen e praktikes - pr.ofsionale per programin e studimit per vitin 2021-2022; Vizita në Institucion (biseda me studentë)* |
| **Kriteri 4.** Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programit të studimit që ofron. | Departamenti i Ekonomisë në bashkepunim me NKSHMJ mban pergjegjesi per evidentimin e kompanive/institucioneve te mundshme per kryerjen e praktikes, si dhe krijimin e lidhjeve me to. Studenti duhet t'i propozoje Departamentit vendin ku mund te kryeje praktiken mesimore. Departamenti ben ndarjen e studenteve neper kompani/institucione pritese, duke respektuar edhe opinionet e shfaqura prej tyre.<br><br>*(RVB)* |
| **Kriteri 5.** Institucioni garanton bashkëpunim me institucione homologe apo institute kërkimore | Bazuar në dokumentacionin e përcjellë nga KUW, janë të listuara rreth 15 marrëveshje në kuadër të programeve bashkepunimi me institucione homologe |

| | |
|---|---|
| shkencore me qëllim realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit dhe studentëve. | apo institucione kerkimore shkencore. Këto marrëveshje kanë për qëllim realizimin e kerkimeve shkencore dhe mobilitetit te personelit dhe studenteve. Poashtu KUW eshte perfshire dhe ne partneritet me këto projekte:<br>• Ne kuader te Programit ERASMUS+ KA107 Programme "Doing Business across cultures", Universiteti i Splites, Kroaci, 13-16 Janar 2020, ku jnaë raportuar se moren pjese 3 studente ne nivel Departamenti të ëEkonomisë<br>• Partner ne implementimin e prnjektit Erasmus+ KA2: "Cooperation for innovation and the exchange of good practices"<br>• Ne kuader te Mobilitetit te stafit te Erasmus + , realizuam leksionin e hapur "Build your Career" nga Prof.Ivana Bilic,nga Universiteti Split, Kroaci.<br><br>*(Aneksi 4.30 Mobility Agreement, Staff Mobility for Teaching, Kontrate midis Dr. Rinaldo Mu9a dhe Erasmus+, Shkurt 2022; Aneksi 4.02 Relacion i Analizes Vjetore te NJKSHMJ, VA 2020-2021; Aneksi 4.25 Propozim dhe Vendim per Konferencen Nderkombetare, Cultural Studies in Business, Mars 2020, "E ardhmja e Europes dhe Kurrikula e Studimeve Kulturore ne Biznes ne kuader teprocesit te Bolonjes"; Aneksi 4.15 Model mbeshtetjeje pedagogu nga institucioni; Aneksi 4.22 Kontrate midis pedagogeve te programit Master i Shkencave ne "Administrim Biznesi" dhe Kolegjit Universitar "Wisdom " Erasmus +; Aneksi 4.26 Relacion mbi Leksionin e hapur me Dr. Marija Stojanova me teme: "Rendesia e dallimeve kulturore ne komunikimin e biznesit dhe negociatat"; RBV; Vizita në Institucion)* |
| **Kriteri 4.** Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programit të studimeve të ciklit të dytë | Mbështetur në takimet me stafin akademik të programit MSC në "Administrim Biznesi", vlerësohet pozitivisht angazhimi optimal i burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programit të studimit. Stafi akademik i angazhuar në këtë program përbëhet nga 1 Profesor, 1 Profesor i Asocuar 5 Doktorë dhe 6 asistentë.<br>Lidhur me stafin e angazhuar në këtë program studimesh, ajo që vihet re nga Grupi i vlerësimit të jashtëm është mbingarkesa e tyre, duke u përfshirë jo vetëm në mësimdhënie por edhe në zyra të tjera mbështetëse të KUW.<br>*(Aneks 2.21.1 Të dhëna tabelare për stafin akademik të përfshirë në program)* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | [redacted] | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | **X** | |

| **Standardi IV.3**<br>**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik e kërkimor, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse. | Mjediset që ofron KUW janë mjedise të përshatshme për zhvillimin e leksioneve/seminareve/laboratorëve. Sallat e leksioneve janë me sipërfaqe të konsiderueshme për zhvillimin normal të mësimit. Sikundër përshkruar edhe më sipër, (Standardi IV.2 Kriteri 1) godina ku zhvillon aktivitetin ky institucion ndodhet në autostradën Tiranë Durrës me një sipërfaqe totale prej 4250 $m^2$. Sipërfaqa e brendëshme zë 3152 $m^2$, në një godinë disa katëshe. Kushtet e godinës janë optimale me facilitate edhe për personat me aftësi të kufizuara.<br>*(Aneks 2.49 Kontratë qeraje, Aneks 2.48 Planimetria dhe Infrastruktura, Vizita e ambienteve)* |
| **Kriteri 2.** Mjediset mësimore, si: klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies. | Nga vizita në institucion, sallat e leksioneve, seminareve, laboratorët janë të pajisura me pajisje audiovizive, PC, videoprojektor, internet etj, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.<br>*(Vizita në institucion)* |
| **Kriteri 3.** Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimit teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi. | Sipas informacionit të siguruar nga dosja e vetëvlerësimit si dhe nga vizita në institucion, rezulton se laboratori informatikës dhe ai i gjuhës së huaj, janë të pajisur me pajisjet e duhura si dhe me softe specifike në ndihmë të objektivave të programit.<br>*(Vizita në institucion)* |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 4.** Institucioni siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron. | Nga të dhënat infrastrukturore, rezulton se institucioni vë në dispozicion të programit të studimi Master "Administrim Biznesi" laboratorë të informatikës dhe atë të gjuhës së huaj.<br>Të dy laboratorët rezultojnë me softe profesionale të finances dhe të kontabiliteit të informatizuar si dhe softe sipas nevojave të stafit dhe studentëve. Departamenti i IT është përgjegjës për mbarëvajtjen dhe monitorimin e cdo pajisje në KUW.<br>*(Vizita në institucion)* |
| **Kriteri 5.** Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike | Referuar vizitës në institucion, RVB dhe dokumentacionit të dorëzuar nga institucioni, rezulton se KUW disponon një tërësi marrëveshjesh me institucione të ndryshme, të cilat mbështesin dhe mundësojnë zhvillimin e praktikave profesionale, kryesisht në mjediset e tyre. Disa nga institucionet dhe bizneset me tw cilat KU Wisdom bashkwpunon janw, Dhoma e Tregwtisw dhe Industrisw, NOA, Procredit Bank, Iris cosmetics, Shwrbimi social shtetwror, etj.<br>*(Aneks 4.05 Tabelat përmbledhese dhe Mareveshjet e bashkepunimit me institucione, Aneks 4.07 Dosja e plotë e marëveshjeve të bashkëpunimit)* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi IV.4**<br>**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit. | KUW vë në dispozicion të studentëve dhe të stafit bibliotekën. Salla e Bibliotekës është e pajisur me kompjutera dhe poste pune studimi. Gjithashtu studentët dhe stafi kanë akses edhe në bibliotekën online, Cobiss. ProQuest është një tjetër faqe që instiucioni ka venë në dispozicion të stafit dhe studentëve.<br>*(Aneks 1.08 Regulation of the Library of University College "Wisdom", Aneks 2.38 Relacion per biblioteken e KUW, lista e teksteve, Vizita në institucion)* |
| **Kriteri 2.** Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit. | Referuar dokumentacionit në dosjen e vetëvlerësimit dhe informacionit të siguruar gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se biblioteka e KUW, është e pajisur me literaturë fizike, sipas librave të referuar në syllabuset e lëndëve për programin Master Shkencor në "Administrim Biznesi". Biblioteka është e pasur edhe më literaturë ndihmëse për ti shërbyer arritjes së objektivave të programit të studimit.<br>Gjithashtu sikundër përshkruar më sipër, KUW mundëson edhe librari elektronike për studentët dhe stafin si ProQuest.<br>Pasurimi i bibliotekës është një proces i vazhdueshëm që fillon që nga departamenti sipas nevojave që stafi ka. |

| | |
|---|---|
| | *(Anex 1.08 Regulation of the Library of University College "Wisdom", Aneks 2.38 Relacion per biblioteken e KUW, lista e teksteve, Vizita në institucion)* |
| **Kriteri 3.** Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët, në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit. | Nga vizita në institucion GVJ konstatoi se biblioteka është e pajisur edhe më një data bazë elektronike<br>Nga RVB rezulton se biblioteka elektronike e KUW përmban rreth 270 tituj fizikë si dhe rreth 136537 tituj elektronikë. Gjithashtu u konstatua se KUW ofron mundesi aksesimi elektronik edhe në ProQuest, ku krijohet mundesi më të zgjeruara për studentët dhe stafin akademik për literaturë dhe lehtësi në aksesim nga cdo mjedis, sidomos gjatë periudhës së pandemisë dhe zhvillimit të proceseve të mësimdhënies on-line pa pagesë.<br><br>*(Aneks 1.20 Te dhena te plota per platformat online struktura e teknologjise se informacionit biblioteka online, Aneks 2.41 Pagesa per blerjen e bibliotekes online ProQuest janar 2022, RVB; Vizita në institucion)* |
| **Kriteri 4.** Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve. | Nga vizita në institucion, konstatohet se biblioteka, manaxhohet nga një soft i cili aksesohet në kompjuterat e instaluar në bibliotekë, biblioteka përmban gjithashtu edhe pajisje kompjuterike si dhe pajisje fotokopjuese. Biblioteka mund të aksesohet nga stafi dhe studentët gjatë një orari të caktuar kohor.<br>*(Vizita në institucion)* |
| **Kriteri 5.** Institucioni duhet të hartojë e zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit. | Institucioni ka një fond të posacëm për blerje librash. Nga vizita në institucion dhe takimet me drejtues të njësive bazë përgjegjëse për për programin e studimeve Master Shkencor në "Administrim Biznesi", konstatohet se kërkesat për pasurim biblioteke vijnë nga stafet akademike të cdo njësie bazë dhe këto kërkesa përpunohen sipas procedurave që KUW ka. Ky argument konkretizohet edhe nga evidence e administruar në dosjen e programit, ku paraqiteet kerkesa për blerjen e librave.<br>*(Aneks 2.27.1 Vendim Nga Dekani per Blerjen e Titujve të Nevojshem në Biblioteke 2021-2022, Aneks 2.27 Propozim nga Departamenti i Ekonomise per Blerjen e Titujve Te Nevojshem në Biblioteke 2021-2022)* |
| **Kriteri 6.** Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj | Biblioteka sipas informacionit të siguruar në RVB, funksionon në orare që janë në përputhje me orarin e studimeve. Orari është i afishuar në hyrje të sallës së bibliotekës.<br>*(Vizita në institucion)* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi IV.5** |
|---|

| **Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit. | Informacioni lidhur me studentët dhe aktivitetin e tyre menaxhohet me anë të një sistemi elektronik, nëpërmjet të cilit studentët kanë akses në shumë informacione që lidhen me mbarëvajtjen e procesit mësimor, oraret, modulet, leksionet, pagesat, etj Studentët mund të aksesjonë në këtë sistem me anë të portalit të studentit. (http://portal.hstalb.xyz/)<br>Sekretaria mësimore, gjithashtu arrimtë menaxhojë informacionin me anë të një sistemi elektronik, sigurisht përvec edhe atij në hard copy me reghistrat themeltarë.<br>Referuar vizitës në institucion dhe takimeve me studentët e programit, "Admnistrim Biznesi", si dhe informacionit në dosjen e vlerësimit të brendshëm, rezulton se institucioni ka aktiv sistemin, ku studentët akesohen me kredencialet e tyre individuale dhe kanë akses në informacionin e rezervuar për ta, notat, leksionet, njoftimet e ndryshme etj. Në regjistrat respektiv, gjendet informacion për regjistrimet e cdo viti, transferimet, diplomimet si dhe rezulatet akademike të cdo student për cdo lëndë.<br><br>*(http://portal.hstalb.xyz/, Anex 1.07 Regulation of Secretary's office of University College"Wisdom", Anex 1.20 Data about online platforms – Information Tecnology Structures – Library –Online Library – etj)* |
| **Kriteri 2.** Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit. | Sipas funksioneve që zyrat kanë, ato disponojnë, manaxhojnë dhe dokumentojnë dokumentacionin respektiv të tyre, në mënyrë elektronike, si sekretaritë, zyra e burimeve njerëzore këshillimit të karrierës dhe jetës studentore, etj |
| **Kriteri 3.** Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.<br><br>**Kriteri 4.** Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve. | Nëpërmjet aksesit online që studentët kanë në sisemin e ofruar nga institucioni, sikundër rezultoi edhe nga takimet me studentët dhe stafin akademik të programit, stafi dhe studentët sigurojnë informacione të posacme për përparimin akademik të studentëve, por edhe për komunikimin student-pedagog për materialet e ndryshme rreth lëndës, leksioneve, frekuentimit detyrave etj. Aksesimi në sistem për cdo student apo pedagog bëhet me anë të një logini dhe një passëordi që mundësohen nga sekretaria mësimore që në momentin e parë hyrës.<br>Portali mundëson një mënyrë mjaft eficente të komunikimit midis stafit dhe studentëve, ku këta të fundit marrin të gjithë informacionin e nevojshëm, si leksione, literaturë, informacion për pikët dhe notat, etj.<br>*(http://portal.hstalb.xyz/)* |
| **Kriteri 5.** Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët. | Sistemi rezulton se është jo vetëm në shërbim të studentëve dhe stafit, por siguron edhe informacion për manaxhimin e institucionit, për ecurinë e procesve të ndryshme, të mësimit, të kontrollit të dijeve, të kalueshmërisë, apo cilësisë së cdo lënde, cilësisë së studentëve ne hyrje dhe ne dalje etj. |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 6.** Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe | Nga kërkimi në web, rezulton se faqja zyrtare e KUW, është funskionale, dhe në të gjendet informacion për studentët, për aktivitetet me interes akademik për stafin dhe studentët si dhe për programet e studimit.<br>Informacioni është i aksesueshëm në gjuhën shqipe dhe anglisht.<br>*(https://Wisdom.edu.al/en)* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi IV.6**<br>**Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.<br><br>**Kriteri 2.** Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë, sipas natyrës specifike të tij. | GVJ konstaton se në zbatim të legjislacionit në fuqi, KUW harton një raport vjetor. Pjesë e këtij raporti rezulton të jetë edhe raportimi financiar i cili kalon nëpër të gjitha nivelet hierarkike, për njohje dhe sugjerime, për miratim final në bordin e Administrimit. Të ardhurat dhe shpenzimet, janë të detajuara sipas burimeve dhe sipas zërave të shpenzimeve.<br><br>Referuar evidencës së konsultuar nga GVJ, rezulton se gjenden të detajuara të ardhurat nga tarifat apo të ardhurat nga projektet si dhe shpenzimet sipas zërave të ndryshëm.<br><br>Pavarësisht se GVJ nuk konstatoi plan financimi në nivel programor, nga vizita në institucion dhe nga RVB, konstaton se buxheti pavarësisht se paraqitet në nivel institucion në formën e tij finale, mënyra e hartimit të tij, përfshin disa nivele, duke nisur nga departamentet e KUW, të cilat paraqesin kërkesat buxhetore për financim, nisur nga nga kërkesat për të mbështetur cdo program studimi, për burime njerëzore, për shpenzime operative, për teknologjitë, shpenzimet për bibliotekën etj.<br><br>*(Aneks 2.51 Projekt buxheti per vitin akademik 2021-2022, Aneks 2.53 Të ardhurat dhe financimet e ndryshme ne 3 vitet e fundit, Aneks 2.54 Pasqyrat financiare)* |
| **Kriteri 3.** Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare | Nga RVB dhe takimi me GVB, dëshmohet se institucioni kryen auditime të brendshme të përvitshme nga strukturat e KUW. Ky raport i dërgohet ë pas administratorit të institucionit.<br>Auditimet fokusohen në zbatimin e ligjshmërisë për krijimin e të ardhurave, realizimin e shpenzimeve dhe deklarimin e tyre.<br>Institucioni nuk ka depozituar raporte auditimi në dosjen e vlerësimit të brendshëm dhe GVJ nuk konsultoi raporte auditimi. Për sa më sipër GVJ i referohet RVB si dhe të dhënave për të ardhurat dhe shpenzimet që institucioni ka depozituar në dosjen e vlerësimit të brendshëm. |

| | |
|---|---|
| për studentët ose ndarjen e burimeve financiare. | *(Aneks 2.51 Projekt buxheti per vitin akademik 2021-2022, Aneks 2.53 Të ardhurat dhe financimet e ndryshme ne 3 vitet e fundit, Aneks 2.54 Pasqyrat financiare)* |
| **Kriteri 4.** Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.<br><br>**Kriteri 5.** Institucioni duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen | Referuar RVB si dhe evidencave të dorëzuara rezulton se është përcjellë informacion për të ardhurat dhe shpenzimet për tre vite akademike, në mënyrë analitike sipas zërave.<br>Këto të dhëna, janë në nivel institucional dhe paraqiten në mënyrë sintetike.<br>Institucioni, ka një strukturë të posacme për manaxhimin financiar sic dëshmohet nëpërmjet RVB, këto struktura auditohen nga auditimi i brendshëm cka dëshmojnë për qëndrueshmërinë financiare të institucionit, në mënyrë të përvitshme. Gjatë vizitës në IAL si dhe gjatë fazës së shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar, nuk është hasur asnjë problematikë lidhur me qëndrueshmërinë financiare të KUW.<br>*(Aneks 2.53 Të ardhurat dhe financimet e ndryshme ne 3 vitet e fundit)* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

## V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

| **Standardi V.1**<br>**Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomiminnë programin e studimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore. | GVJ konstaton se KUW ka një sërë rregulloresh dhe procedurash duke filluar nga niveli institucional në tërësi e deri tek departamenti apo programi i studimit që mbulojnë një cikël të plotë nga hyrja deri në diplomim të studentëve në Master Shkencor në "Administrim Biznesi".<br><br>Orientimi dhe këshillimi i studentëve është i sanksionuar në Statutin dhe Regulloren e KUW, në Rregulloren e Departamentit të Ekonomisë si dhe në regulloren e programit të studimit në "Administrim Biznesi".<br><br>Ky informim nis nga momenti i informimit për programet akademike, para fillimit të cdo viti, nëpërmjet webit të KUW ku gjenden të publikuara, |

| | |
|---|---|
| | programet, planet mësimore si dhe kuotat e kriteret e pranimit si dhe pranë zyrave të institucionit për të gjithë studentët e interesuar.<br><br>*(Anex 1.01 Statute of University College "Wisdom", Anex 1.02 Regulation of University College Wisdom, Aneks 2.10 Rregullore e Departamentit të Ekonomise, Aneks 3.01 Rregullore e Programit të Studimit Master Shkencor në Administrim Biznes)* |
| **Kriteri 2.** Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit. | GVJ referuar evidencave si dhe informacionit gjatë takimit me studentët e programit të studimit Master Shkencor në "Administrim Biznesi", është e mendimit se aktet rregullatore ku sanksionohen politikat dhe procedurat që ndiqen nga hyrja në dalje e studentëve, ofrojnë trajtimin e drejtë dhe të barabartë të studentëve mbështetur mbi meritokracinë. Referuar këtu politikave të pranimit, atyre të frekuentimit, të ankimimit si dhe të vlerësimit të arritjeve akademike të studentëve, orientohen drejt garantimit të barazisë, paanshmërisë dhe transparencës.<br><br>*(Aneks 1.07 Regulation of Secretary's office of University College "Wisdom", Anex 1.10 Regulation on Student Relation ,Public and Coordination)* |
| **Kriteri 3.** Kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku. | GVJ konstaton se përvecse janë të sanksionuara në rregulloret e institucionit të sipërcituara, këto kritere pranimi, transferimi, ekuivalentimi dhe vlerësimi të dijeve, janë të qarta për studentët, ato gjenden në webin e insitucionit të publikuara dhe lehtësisht të aksesueshme, po ashtu pedagogët e lëndëve, sqarojnë cdo fillim semstri politikat e frekentimit dhe vlerësimit të dijeve, duke mundësuar informacion të plotë për studentët rreth këtyre procedurave.<br><br>*(Anex 1.01 Statute of University College "Wisdom", Aneks 2.58 Rregullore e Transferimeve, Aneks 3.11 Programet Mesimore Syllabuset), Vizita në institucion,* |
| **Kriteri 4.** Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t'u pranuar në ciklin e dytë të studimeve. | Referuar takimeve me drejtuesit e njësisë kryesore dhe atyre bazë, përgjegjëse për këtë program studimesh në "Administrim Biznesi", RVB dhe webit të institucionit, rezulton se KUW harton dhe publikon kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve, për t'u pranuar në ciklin e dytë të Masterit Shkencor dhe orienton studentët e ardhshëm sesi të aplikojnë dhe për fazat e aplikimeve.<br>*(https://www.Wisdom.edu.al)* |
| **Kriteri 5.** Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni i arsimit të lartë udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit | Për përcaktimin e kritereve rezulton se zbatohen legjislacioni në fuqi, në zbatim të akteve nënligjore të ministrisë përgjegjëse për arsimin, si dhe në maturën shtetërore. Rezulton se KUW, në bashkëpunim me departamentin e Ekonomisë, orientojnë studentët e interesuar rreth kritereve, afateve, programit, mënyrës së zhvillimit të tij etj.<br>Nga dokumentacioni i dorëzuar rezulton edhe shpërndarja e broshurave, informimi përmes webit, rrjeteve sociale.<br>*(Aneks 3.16 Guida e Studentit)* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| **Standardi V.2** |
|---|

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.**

| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
|---|---|
| **Kriteri 1.** Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin. | GVJ konstaton nga evidencat në DVV si dhe nga takimet me stafin dhe studentët e programit, se studentët informohen për kriteret e frekuentimit si për kriteret dhe format e vlerësimit të dijeve.<br>Për këtë institucioni informon nëpërmjet rregulloreve ku janë të parashikuara, si rregullore e fakultetit, rregullore departamentit, po ashtu nëpërmjet syllabuseve dhe orientimit nga stafi akademik dhe sekretaria mësimore.<br><br>*(Aneks 2.08 Rregullore e Fakultetit te Shkencave Ekonomike Shoqerore, Aneks 2.10 Rregullore e Departamentit te Ekonomise, Aneks 3.01 Rregullore e Programit të Studimit Master Shkencor në Administrim Biznes, Vizita në Instiucion)* |
| **Kriteri 2.** Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme. | GVJ konstaton KUW informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme si dhe mundësitë për njohjen e lëndëve të cilat kanë ngjajshmëri.<br><br>*(Aneks 3.01 Rregullore e Programit të Studimit Master Shkencor në Administrim Biznes, Aneks 2.58 Rregullore e Transferimeve, Vizita në Instiucion)* |
| **Kriteri 3.** Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit. | GVJ vlerëson se KUW informon studentët në foma alternative rreth vlerësimit të dijeve.<br>Njohja dhe informimi rreth rregulloreve nga zyrat e këshillimit të studentëve dhe Karierrës, apo nga pedagogët e lëndës në fillim të cdo semestri janë format që informojnë studentët e programit të studimit në "Administrim Biznesi".<br>*(Aneks 3.01 Rregullore e Programit të Studimit Master Shkencor në Administrim Biznes, Aneks 3.11 Programet Mesimore Syllabuset)* |
| **Kriteri 4.** Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit. | Studimet e ciklit të studimeve Master shkencor në Administrim Biznesi, përfundojnë me mbrojtjen e demës së diplomës. Studentët orientohen për temën e diplomës nga udhëheqësi i tyre si dhe nga departamenti sipas rasteve specifike.<br>*(Aneks 3.13 Rregullore Mbi Standartet dhe Rregullat e Punimit, Udheheqjes, Mbrojtes dhe Vlersimit të Temave të Diplomave për Master Shkencor në Administrim Biznes)* |
| **Kriteri 5.** Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit | Nga takimi me përfaqësues së zyrës së Bueimeve Njërëzore Këshillimit të Karierës dhe Jetës Studentore, institucioni orienton studentët. Kjo nëpërmjet komunikimit të drejtëpërdrejtë me ta, si dhe nëpërmjet broshurave orientuese që shpërndan. Cdo fillim viti organizohen edhe ditët orientuese për studentët. Gjithashtu një instrument tjetër që institucioni përdor janë rrjetet sociale si dhe web sitin e institucionit.<br>*(Aneks 3.16 Guida e Studentit, Aneks 3.17 Udhezuesi Didaktik i Programit të Studimit Master Shkencor në Administrim Biznes)* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi V.3**<br>**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.<br><br>**Kriteri 2.** Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.<br><br>**Kriteri 3.** Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.<br><br>**Kriteri 4.** Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.<br><br>**Kriteri 5.** Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.<br><br>**Kriteri 6.** Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin mësimor të studentëve | GVJ konstatoi nga takimet me drejtues të njësisë bazë, me stafin e programit, sekretarinë dhe studentët e Masterit Shkencor në "Administrim Biznesi", se departamenti përgjegjës si dhe sekretaria mësimore, informojnë studentët në lidhje më strukturën e organizimit të programit.<br><br>Gjithashtu edhe zyra Burimeve Njerëzore, Këshillimit e Karierës, informon në javën e parë të fillimit të programit master rreth organizimit, kohëzgjatjes dhe pyetjeve të ndryshme rreth programit të studimit. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij, kryesisht gjatë javës së parë të fillimit të studenimeve në KUW, e në vijim për cdo infomacion që studentët kanë nevojë, këto struktura, si departamenti i Ekonomisë, sekretaria mësimore, tutoriati i studentëve apo zyra e këshillimit të studentëve informojnë sipas kërkesave të posacme që studentët mund të kenë.<br><br>Institucioni nëpërmjet zyrës së karierës informon për mundësi praktike në kompani të ndryshme, për mundësi të reja punësimi, orienton për mundësitë dhe formalizimin e aplikimeve për punë etj.<br><br>Studentët informohen nga strukturat e mësipërme për strukturën e vitit akademik, për kalendarin e provimeve, për orarin mësimor. Disa dokumenta mbështetëse rreth këtij informimi janë pjesë edhe DVV si dhe publikohen në webin e KUW, sic rezulton nga referencat më poshtë, duke lehtësuar aksesimin e tyre nga studentët<br><br>GVJ konstatoi nga takimet me stafin akademik por edhe me studentët se, cdo pedagog gjatë javës së parë të cdo viti informon studentët për lëndën, syllabusin, temat !iteraturën dhe detyrimet akademike të cdo lënde.<br><br>*(Aneks 3.16 Guida e Studentit, Aneks 3.17 Udhezuesi Didaktik i Programit të Studimit Master Shkencor në Administrim Biznes, Aneks 3.18 Relacion për Pjesemarrjen e KUW në Ditet e Informimit të Maturanteve, Aneks 3.19 Relacion i Zyres së Burimeve Njerzore Keshishimit të Karrieres dhe Jetes Studentore për Trajnimin me Teme si të Realizojme nje Aplikim për Pune)* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| **Standardi V.4**<br>**Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit të ciklit të dytë, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 1.** Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve në programin e studimit.<br><br>**Kriteri 2.** Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit të ciklit të dytë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimit.<br><br>**Kriteri 3.** Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimit që nga pranimi, deri në diplomimin e tyre.<br><br>**Kriteri 4.** Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.<br><br>**Kriteri 5.** Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve | GVJ gjatë vizitës në KU Wisdom si dhe takimeve me përfaqësues të sekretarisë mësimore, konstaton se institucioni, disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve për cdo program studime dhe specifikisht për programin Master Shkencor në "Administrim Biznesi". Sipas informacionit të siguruar përvec regjistrave të institucionit, që GVJ konsultoi këto informacione ruhen edhe në mënyrë elektronike.<br><br>Referuar rregjistrave themeltar rezulton se:<br><br>Numri i studentëve të regjistruar për herë të parë, për vitin akademik:<br>- 2021-2022 16 studentë<br>- 2020-2021 30 studentë<br>Gjatë vitit 2020-2021 rezultojnë 24 studentë të diplomuar.<br><br>GVJ konsultoi proceverbale të lëndëve, vlerësimet e studentëve për lëndë të ndryshme, si dhe regjistrat e notave dhe konstatoi përputhshmëri mes formave të vlerësimit në syllabus si dhe regjistrave të notave. Nga takimi me studentët rezultoi se studentët për vlerësimet e tyre informohen nëpërmjet portalit që aksesohet nëpërmjet kredencialeve individuale.<br><br>KUW disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimit që nga pranimi (mesataren në hyrje), deri në diplomimin e tyre dhe rezulton se i analizon ato në analizat vjetore.<br><br>GVJ gjatë vizitës në institucion, konsultoi regjistrat themeltar ku çdo student, është rregjistruar dhe ishte pajisur me numër matrikullimi.<br><br>Gjithashtu GVJ konsultoi dosje të studentëve të regjistruar, të cilat përmbanin dokumentacionin e duhur dhe të noterizuar, si diploma e bachelorit, listë notash, fotokopje e kartës së identitetit etj.<br>*(Aneks 2.17 Te Dhena Tabelore mbi Cilesine në Hyrje dhe ne Dalje të Studenteve të Programit të Studimit Master Shkencor në Administrim Biznes, Aneks 2.09 Analiza Vjetore e Fakultetit të Shkencave Ekonomike dhe Shoqerore, Aneks 1.07 Rreg. Sekretarise Mesimore, Vizita në institucion)* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

**Standardi V.5**
**Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.**

| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
|---|---|
| **Kriteri 1.** Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve. | Referuar takimeve në institucion me studentët e programit si dhe me strukturat e këshillimit të studentëve dhe të karierës, rezulton se studentët kanë aktiv dhe kanë organizuar këshillat studentorë.<br>Çdo kurs ka zgjedhur përfaquesin e vet-senator në këshillin studentor, i cili funksionon mbi regulloren e sanksionuar të këshillit studentor. Gjithashtu stedentët kanë edhe përfaqësuesin e tyre në Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. |

| | |
|---|---|
| | Nga takimet me studentët GVJ konstatoi se vetë studentët ishin pak të paqrtë për përfaqësuesinë e tyre në Senatin Akademik të IAL. *Sygjerohet një ndërgjegjësim dhe orientim më i mirë për studentët lidhur me të drejtën e tyre për tu përfaqësuar në Senat, dhe jo vetëm të kenë një përfaqësues/senator grupi.*<br><br>*(Anex 1.01 Statute of University College"Wisdom", Aneks 2.19 Të Dhena Tabelore për Njesite, Individet, Studentet dhe Pale të Tjera të Angazhuara në Sistemin e Sigurimit të Brendshem të Cilesise, Vizita në Institucion)* |
| **Kriteri 2.** Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme. | Sic rezultoi nga takimi me studentët e programit, ata kanë aktiv këshillin studentor, ku cdo senator/anëtar këshilli studentor, përcjell kërkesat e studentëve, për proceset akademike apo të marrëdhënieve me studentët, që burojnë prej tyre, zyrave përkatëse.<br>GVJ konstatoi pjesëmarrje të studentëve në organet e tjera vendimmarrëse sic është Senati Akademik, NjSBC, për të realizuar dhe integruar një përfshirje më të plotë të studentëve të KUW, në vendimmarjen e institucionit, por sikundër u thekësua edhe më sipër procesi i pjesëmarjes së tyre në këto organe duhet të jetë më i qartë nga pikëpamja proceduriale si dhe duhet të transmetohet më hapur tek studentët.<br><br>*[Aneks 1.13 Rregullore e keshillit studentor, Aneks 3.20 Procesverbal per zgjedhjen e kryetarit te keshillit studentor, Vizita në Institucion]* |
| **Kriteri 3.** Në hartimin dhe përmirësimin e programit të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme. | GVJ është e mendimit se KU Wisdom në hartimin dhe përmirësimin e programeve të studimit, mban parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin "Administrim Biznesi" dhe se ka procedura joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme. Evidencë për këtë shërben konstatimi i transferimit të studentëve nga IAL të tjera drejt KUW, në vitet e fundit akademike, edhe pse në programe të tjera studimi, por që janë të profilit ekonomik.<br>Ngarkesa akademike e studentëve është e dhënë qartë në dokumentacionin e paraqitur nga IAL. Kështu përkatësisht ngarkesa në auditor e studentëve është, 450 leksione, 225 seminare, 225 ushtrime/laboratorë, 300 praktikë dhe 450 diploma, për të marë një total prej 1650 orësh.<br>*ëAneks 2.18 Të Dhena Tabelore për Ngarkesen e Studenteve në Auditor]* |
| **Kriteri 4.** Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to.<br><br>**Kriteri 5.** Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të | Sic rezultoi nga takimi që GVJ pati me përfaqësues të studentëve dhe të NJSBC, institucioni organizon dy herë në vit, pyetësorë për studentët për të siguruar informacion dhe sugjerime prej tyre rreth, ecurisë së programit të studimit. Përvec pyetësorëve KUW rezulton se organizon edhe fokus grupe për tu thelluar në gjetje dhe në sugjerime nga studentët për rishikimin dhe përmirësimin e programit të studimit edhe me kontributin e tyre<br>GVJ konstaton se studentët kanë të sanksionuar në rregullore, të drejtën e ankimimit si dhe të drejtën e rishikimit të rezultateve të vlerësimit të tyre. Referuar takimeve me stafin akademik dhe me studentët, ata kanë të drejtën e ankimimit të rezultatit dhe konsultimit me tezën e provimit për tu qartësuar për vlerësimin e tyre. |

| | |
|---|---|
| rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës | Gjithashtu nëpërmjet anketimeve semestrale, studentët kanë të drejtë të shprehin perceptimet e tyre, mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve.<br><br>*(Anex 1.02 Regulation of University College Wisdom, Aneks 2.55 Relacion të Kalendareve të Kontrollit NJSBC, Aneks 2.57 Raporte të Takimeve të Studenteve me Pedagoget dhe NJSBC)* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | [redacted] | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | X | |

| **Standardi V.6**<br>**Personeli akademik i angazhuar në programin e studimit merr pjesë në aktivitetet kërkimore e shkencore dhe motivon pjesëmarrjen e studentëve dhe përfshirjen e tyre në studime e projekte.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Personeli akademik merr pjesë në konferenca ose aktivitete ndërkombëtare në fushën e kërkimit shkencor. | Personeli akademik i angazhuar në programin Master Shkencor në Administrim Biznesi, është i angazhuar në pjesëmarrje në konferenca dhe aktivitete kombëtare dhe ndërkombëtare. Ky aktivitet është i pasqyruar analizën shkencore që departamenti realizon në mënyrë periodike cdo vit dhe gjithashtu pjesë e analizës vjetore të IAL. Analiza përcakton qartësisht politikat e kërkimit shkencor, kërkimin shkencor, ecurinë e studimeve të ciklit të dytë të studimeve, aktivitetin shkencor dhe botues, pjesëmarrjen në konferenca shkencore.<br><br>*(Aneks 4.02 Raport Vjetor i Veprimtarise së Njesise së Kerkimit Shkencor dhe Marredhenieve me Jashte Viti Akademik 2020-2021, Aneks 4.04 Programi Vjetor i Veprimtarive Kerkimore Shkencore Viti Akademik 2020-2021, 2021-2022)* |
| **Kriteri 2.** Institucioni lidh marrëveshje partneriteti me institucionet e huaja të arsimit të lartë, institute, me qëllim realizimin e studimeve, projekteve dhe kërkimeve të përbashkëta. | Aktiviteti i KUW ka qënë dhe është për mjaft vite shumë i angazhuar për të rritur mundësitë e bashkëpunimeve me institucione partnere, brenda dhe jashtë vendit. Qëllimi ka qënë jo vetëm ndërkombëtarizimi i punës së IAL por edhe krijimi i mundësive për të përfituar nga rezultatet e projekteve me qëllim përmirësimin e procesit mësimor, kërkimor dhe infrastrukturor të departamentit, fakultetit dhe IAL në tërësi. Aktualisht numëron rreth 20 projekte bashkëpunimi të financuar nga fondet e BE, si me universitetin La Sapienza Romë, International Balcan University, Kolegji Europian i Kosovës, etj.<br><br>*(Aneks 4.07 Dosja e Marreveshjeve të Bashkepunimit)* |
| **Kriteri 3.** Personeli akademik motivon studentët të hartojnë, shkruajnë dhe publikojnë studime e punime shkencore. | Përgjatë studimeve në cilkin master shkencor, studentët inkurajohen të propozojnë temat e tyrë të mikrotezës, që paraqesin qartësisht një studim konkret për një cështje të caktuar. Propozimet diskutohen me profesorin udhëheqës i cili është përgjegjës për ecurinë e punës kërkimore të studentit. Kërkimet më të mira janë prezantuar në konferenca studentore që zhvillohen pranë KUW.<br><br>*(Aneks 4.09 Relacion Leksion i Hapur si të Shkruajme nje Artikull Shkencor)* |
| **Kriteri 4.** Institucioni mbështet publikimin në revista shkencore ndërkombëtare të punimeve kërkimore shkencore të personelit akademik të institucionit dhe studentëve. | Departamenti dhe institucioni, inkurajon dhe mbështet si stafin akademik ashtu edhe studentët të publikojnë punimet e tyre në revista shkencore brënda dhe jashtë vendit. Rrugët dhe mënyrat që janë praktikuar kanë qënë përmes<br>1. Mbështetjes përmes projekteve të nënshkruara nga IAL<br>2. Financimi i pjesëmarrjes në konferenca të organizuara nga vetë IAL<br>Departamenti inkurajon gjithashtu studentët e masterit shkencor të marrin pjesë në konferenca shkencore. Organizimi kalon përmes filtrave shkencorë. |

| | |
|---|---|
| | *(Anex 1.14 Strategy on Scientific Research, Projects, Partnerships and International Mobility of University College"Wisdom", Aneks 2.09 Analiza vjetore e Fakultetit te shkencave ekonomike dhe shoqerore)* |
| **Kriteri 5.** Institucioni dhe personeli akademik motivojnë dhe mbështetin studentët të angazhohen në studime inovative dhe patentave.<br><br>**Kriteri 6.** Personeli akademik ofron asistencën e nevojshme për kryerjen e analizave, matjeve studimeve dhe përpunimit të rezultateve në kuadër të realizimit të diplomës | Studentët inkurajohen të përdorin dhe aplikojnë metoda dhe metodologji innovative të cilat do tju jepnin mundësi atyre të jenë më afër realitetit dhe nismave bashkëkohore të kërkimit shkencor dhe të përdorimit të teknologjive të inovacionit.<br><br>Stafi akademik i departamentit të Ekonomisë është i përfshirë në mënyrë aktive në procesin e konceptimit, shkrimit dhe analizës së punës së studentëve me mikrotezat. Pedagogët realizojnë në mënyrë periodike takime me studentët të cilët kanë në udhëheqje duke vlerësuar performancën dhe progresin e tyre. Këto takime strukturohen në përcaktimin e temës dhe strukturës së punimit, më pas në përpilimin dhe zbatimin e metodës së studimit dhe në fund analizën dhe interpretimin e rezultateve. Pedagogu udhëheqës gjithashtu orienton studentin për prezantimin para komisionit të mbrojtjes. Udhëheqësi i punimit të diplomës përgatit programin e punës së studentit, duke vendosur edhe afatet e përafërta të realizimit të tij. Studenti duhet të respektojë afatet e vendosura për të bërë të mundur mbrojtjen me sukses të temës në sezonin normal të mbrojtjes së diplomës.<br>Para mbrojtjes së punimit të diplomës, udhëheqësi rishikon dhe miraton punimin e kryer nga studenti dhe lejon mbrojtjen e tij duke e firmosur atë.<br><br>*(Aneks 2.32 Vendim i Administratores se Sh.P.K Wisdom per Mbeshtetjen e Veprimtarive Kerkimore Shkencore per Vitin Akademik 2021-2022, Aneks 3.13 Rregullore mbi standartet dhe rregullat e punimit, udheheqjes, mbrojtes dhe vlersimit te temave te diplomave per master shkencor ne Administrim Biznes, Aneks 4.04 programi vjetor i veprimtarive kerkimore shkencore viti akademik 2020-2021,2021-2022)* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi V.7**<br>**Mbështetja e institucionit të arsimit të lartë siguron vazhdimësi në studime të thelluara dhe kërkim shkencor.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni ndjek një politikë bashkëpunimi me organizmat shkencorë, kombëtarë, me qëllim rritjen e aktiviteteve dhe mobilitetit të stafit dhe studentëve të programit të studimit. | Në kuadër bashkëpunimeve me institucione homologe, KU Wisdom ka qënë aktiv në krijimin e lidhjeve për të mundësuar shkëmbimin e eksperiencave të stafit dhe studentëve. Kjo është materializuar përmes marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucione të tjera IAL brenda dhe jashtë vendit. Aktualisht KUW ka disa marrëveshje të firmosura të cilat shfrytëzohen për studentët dhe stafin e programin të masterit shkencor në Administrim Biznesi. Stafi ka patur mundësi shkëmbimi experience me universitet partnere ndërkohë që ka patur edhe ardhje nga universitetet partnere në drejtim të KUW.<br><br>*(Aneks 1.14 Strategji e kerkimit shkencor projekteve parteriteteve e mobilitetit nderkombetar, Aneks 4.08 Relacion per trajnimet nderkombetare te studenteve)* |
| **Kriteri 2.** Implementimi i metodave të kërkimit nga personeli akademik dhe studentët siguron vijueshmëri dhe | Bazuar në RVB dhe në takimet e realizuara u paraqit se konceptimi dhe ndërtimi i kurrikulës së programit të masterit shkencor është realizuar me ambiencien për të përgatitur studentë me kompetenca dhe aftësi për tu |

| | |
|---|---|
| përgatitje të studentëve për ciklin e tretë të studimeve. | adaptuar në tregun e punës po aq sa edhe për të qënë pjesë e studimeve të mëtejshme. Në programin e masterit shkencor janë përfshirë lëndë me karakter formues, analitik dhe profesional. Kjo u krijon atyre mundësinë të kënë njohuri të duhura në dimensione të ndryshme profesionale por edhe të kenë aftësi për të përdorur metoda dhe teknika që mundësojnë vazhdimin e kërkimit në ciklin e tretë të studimeve. Kështu module të tilla si Metodologjia e kërkimit shkencor, Sistemet e Informacionit të Manaxhimit dhe Menaxhim Projektesh dhe Kontratash, u krijojnë mundësinë studentëve të kenë formim të plotë në lidhje me aplikimin e metodave bashkëkohore.<br><br>*(Aneks 3.03 Planet Mesimore, Lenda Sistemet e Informacionit të Manaxhimit, Lenda Manaxhim Projektesh dhe Kontratash, Lenda Metodat e Kerkimit Shkencor)* |
| **Kriteri 3.** Institucioni ndjek një politikë të përfshirjes së studiuesve të rinj në projekte kërkimore vendës dhe të huaj.<br><br>**Kriteri 4.** Institucion ndjek një politikë integruese për kërkuesit shkencorë të huaj. | Politikat e kërkimit të Institucionit janë konceptuar, për të qënë gjithpërfshirëse dhe duke inkurajuar pjesëmarrjen e studiuesve të rinj. Për arsye të energjisë, interesave dhe adaptueshmërisë studiuesit e rinj kanë qënë pjesë integrale e projekteve kërkimore vëndase dhe të huaj.<br>Dokumentacioni bazë i ofruar nga KUW për të mbështetur aktivizimin e stafit në projekte kërkimore është Plani Strategjik i Kolegjit 2018-2023, Strategjia e Kërkimit Shkencor, Projekteve, Partneritetit dje Mobiliteteve ndërkombëtare.<br>Departamenti ka ftuar dhe pranuar një numër kërkuesish të rinj nga Universitet e huaja për të rritur bashkëpunimin midis anëtarëve të departamentit dhe kërkuesve nga universitete të tjera. Disa nga shëmbujt që na u ufruan për të mbështetur përfshirjen e kërkuesve të huaj në KUW janë, workshop 2 javor i ofruar nga Prof. Ronald Nate, leksion i hapur nga Marija Stolanova, leksion i hapur nga Schuman, leksion i hapur nga Sing Huin Kun, etj.<br><br>*(Anex 1.14 Strategy on Scientific Research, Projects, Partnerships and International Mobility of University College "Wisdom", Anex 1.03 Strategic Plan 2018-2023 of University College "Wisdom", Aneks 4.13 Dosja e Plote e Workshopit të Zhvilluar nga Pedagogu Amerikan Ronald M.Nate, Aneks 4.26 Relacion mbi Leksionin e me Dr Marija Stojanova me Teme Rendesia e Dallimeve Kulturore në Komunikimin e Biznesit dhe Negociatat)* |
| **Kriteri 5.** Institucioni ndjek një politikë favorizuese për mobilitetitin e studentëve që angazhohen në veprimtari e aktivitete ndërkombëtare.<br><br>**Kriteri 6.** Institucioni, për të rritur profilin ndërkombëtar, fton për veprimtari kërkimore dhe mësimdhënie, personel akademik dhe studentë të huaj, për periudha të ndryshme kohore | Departamenti i Ekonomisë orientohet drejt politikave favorizuese për mbështetjen e studentëve. Janë realizuar mobilitete, megjithëse relativisht të pakta, me karakter studimor apo edhe për shkëmbime eksperiencash për mësimdhënie dhe trajnimi. Është mundësuar nëpërmjet një marëveshje Erasmus+ qëndrimi 1 javor në Rumani. Gjithashtu studentët kanë patur mundësi të jenë pjesë e një trajnimi 3 ditor në Kroaci.<br>GVJ vlerëson përpjekjet e KU Wisdom për të rritur bashkëpunimet dhe lidhjet e marëveshjeve me IAL të huaja. Ndërkohë që *rekomandon të intensifikohen përpejkjet pët të shtuar numrin e marëveshjeve dhe të shtohen mobilitetet e stafit dhe të studentëve.*<br><br>Sikundër është përshkruar edhe më sipër (Kriteri 3 & 4), institucioni ka ftuar në vazhdimësi lektorë të huaj për leksione të hapura apo ëorkshope. *Ndërkohe nuk janë dhënë evidenca për ardhjen e studentëve të huaj në drejtim të KUW. Rekomandohet që IAL të intensifikojë përpjekjet dhe të sigurojë kushtet e nevojshme për pritjen e studentëve të huaj.*<br><br>*(Aneks 4.26 Relacion mbi Leksionin e me Dr Marija Stojanova me Teme Rendesia e Dallimeve Kulturore në Komunikimin e Biznesit dhe Negociatat,* |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | *Aneks 4.19 Relacion mbi Leksionin e Hapur të Zhvilluar nga Lektori Sung Huin Kun me Teme Mind Education)* | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | [redacted] | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | X | |

| **Standardi V.8**<br>**Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve. | Nga vizita në institucion si dhe nga dokumentacioni i sjellë nga IAL, GVJ konstaton se KUW ka procedura dhe njësi të posacme në strukturën organizative që kanë në fokus shërbimin e informimit të studentëve, që në fazën e hyrjes deri në diplomim. Këto shërbime ofrohen kryesisht nga zyra e Burimeve Njerëzore Këshillimit të Karrierës dhe Jetës Studentore.<br>Gjithashtu në iformimin e studentëve një rol mjaft të rendësishëm luan edhe vetë departamenti.<br>GVJ konstaton se KU Wisdom ka funksional sistemin për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre, për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin Master Shkencor në "Administrim Biznesi". Ky sistem ka të integruar aktivitetin e disa zyrave, Sekretaria mësimore, koordinatorja e programit, Zyra e BNJKKJS.<br>Të gjitha këto zyra, në bashkëpunim edhe me departamentin e Ekonomisë, orientojnë studentët përgjatë jetës studentore si dhe me mundësitë për punësim.<br>Ky sistem mbështetet edhe nga informimi në rrjetet sociale të studentëve.<br>Nga takimi me përfaqsues të ZBNJKKJS dhe të studentëve, rezulton se kjo zyrë, asiston studentët dhe këshillon ata për ecurinë e karierrës së tyre, duke i orientuar drejt zgjedhjes së profilit të studimeve, duke i orientuar drejt mundësive të punësimit, apo për oportunitetet e zgjedhjes dhe zhvillimit të praktikës profesionale, pranë kompanive, më të cilat KUW ka marrëveshje dhe që konsiderohen aktive.<br>Referuar DVV si dhe takimeve përfaqsues të zyrës, institucioni nëpërmjet specialists së ZBNJKK&JS, ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit, duke azhurnuar të dhënat me të diplomuarit si dhe më punësimin e tyre.<br>Në vijim institucioni përgatit statistika për punësimin e studentëve për organet drejtuese për vendimmarrje të ndryshme të tyre.<br>Ajo që GVJ vuri re, sikundër është thekësuar edhe më sipër është organizimi i vetë zyrës BNJKK&JS. *Institucionit i rekomandohet të ndajë këtë zyrë në 2 njësi të vecanta, ku njëra të meret me Burimet Njerezore, rekrutimet, stafin, etj. Ndërkohë që zyra tjetër të meret me këshillimin e Karrierës dhe jetën studentore.* |
| **Kriteri 2.** Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit. | |
| **Kriteri 3.** Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës. | |
| **Kriteri 4.** Zyra/njësi e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse | |

| | |
|---|---|
| | *ëAnex 1.09 Regulation of Human Resources, Aneks 2.24 Të Dhena Tabelore Permbledhese për Punesimin Real të Studenteve, Vizita në Institucion]* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | X | |

| **Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | X | |

## VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT MASTER I SHKENCAVE/ARTEVE

| **Standardi VI.1**<br>**Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.<br><br>**Kriteri 2.** Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentë dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm. | GVJ referuar raportit, dokumentacionit të depozituar si dhe takimeve në institucion konstaton se KUW ka ngritur Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë si dhe Komisionin për Garantimin e Standarteve të Cilësisë.<br><br>Përgjegjësitë e NJSBC, janë sanksionuar në statutin dhe rregulloren përkatëse. Kjo njësi është përgjegjëse për monitorimin e cilësisë, dhe operon mbështetur në strategjinë institucionale dhe mbështetur në manualin e saj ku përcaktohen procedurat që njësia ndjek. NJSBC, referuar takimeve në institucion, operon duke përdorur disa mekanizma dhe duke integruar rezultatet që këto mekanizma sigurojnë. Në vendosjen në funksion të këtyre mekanizmave, NJSBC, bashkëpunon dhe mërr input vlerësimi nga:<br><br>- stafet akademike nëpërmjet vetëvlerësimit,<br>- departamenti përgjegjës nëpërmjet monitorimit<br>- studentët nëpërmjet pyetësorëve që ata plotesojnë apo fokus grupeve<br>- strukturave të tjera mbështetëse si Zyra e Burimeve Njerëzore<br>- ekspertë të jashtëm<br>GVJ vlerëson pozitivisht praktikën e ndjekur nga institucioni për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë në KUW, duke përfshirë edhe ekspertë të jashtëm.<br><br>*(Aneks 2.28 Vendim për Emerimin e Anetareve të NJSBC, Aneks 2.30 Vendim Emerimi i Anetareve të Komisioneve të Perhershme, Aneks 2.56 Politika për Garantimin e Standarteve të Cilesise, Aneks 2.57 Raporte të Takimeve të Studenteve me Pedagoget dhe NJSBC)* |
| **Kriteri 3.** Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe | GVJ konstaton nga takimi me studentët, drejtuesit, stafin akademik si dhe përfaqsues të NJSBC, se KUW përdor mekanizma të ndryshëm që synojnë vlerësim të cilësisë së programit të studime, sic janë përdorimi i pyetësorëve, fokus grupeve, kontrolleve nga departamentet, kontrollit të provimeve dhe syllabuseve me qëllim që të monitorohen proceset e ndryshme.<br>Rezulton se institucioni përvec mekanizmave të vlerësimit të brendshëm, i nënshtrohet vlerësimit të jashtëm periodik në nivel institucional dhe në nivel |

| | |
|---|---|
| proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë. | programesh studimore duke ju referur institucioneve përkatëse sikundër është ASCAL.<br>Për sa më sipër GVJ konsultoi formate pyetësorësh, fokus grupesh, plane masash për zbatim rekomandimesh, në dosje e vetëvlerësimit si dhe nga infomacioni i siguruar gjatë vizitës në institucion.<br><br>*(Aneks 2.05 Plani i Punes së GVB për Akreditimin Periodik të Programit të Studimit, Vizita në institucion)* |
| **Kriteri 4.** Institucioni ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programit të studimit që ofron, në kuadër të SBC-së. Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njësive përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit | GVJ konstaton që NJSBC është krijuar në përputhje me aktet ligjore në fuqi si dhe në Statitin e KUW. Kjo njësi ka një manual të operimit të saj dhe ka një tërësi mekanizmash dhe procedurash të integruara duke synuar kështu krijimin e një kulture cilësie me përfshirjen e të gjithë aktorëve, staf akademik, admnistrativ, studentë, drejtues, përfshirë edhe ekspertë të jashtëm.<br>GVJ konstaton dhe vlerëson pozitivisht se këto procese janë intensifikuar, referuar situatës gjatë akreditimit të fundit periodik të këtij programi.<br>*(Anex 1.01 Statute of University College "Wisdom", Anex 1.06 Regulation of IQAU of University College "Wisdom")* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi VI.2<br>Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni ngre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programit të studimit të ciklit të dytë. | GVJ konstaton, nga infomacioni i siguruar gjatë vizitës në institucion me drejtues të njësive bazë dhe të NJSBC si dhe referuar manualit saj, është njësia e posacme që ndjek sigurimin e cilësisë në bashkëpunim me departmentin e Ekonomisë, përgjegjës për programin Master Shkencor në "Administrim Biznesi". Departamenti, monitoron zbatimin e planit mësimor dhe merr vendime për ndryshime në kurrikulë kur kjo gjykohet e nevojshme për përmirësimin e cilësisë së programit të studimit.<br>*(Anex 1.06 Regulation of IQAU of University College "Wisdom", Aneks 2.56 Politika për Garantimin e Standarteve të Cilesise, Aneks 2.57 Raporte të Takimeve të Studenteve me Pedagoget dhe NJSBC)* |
| **Kriteri 2.** Institucioni përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programit të studimit të ciklit të dytë.<br><br>**Kriteri 3.** Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programit të studimit. | Referuar takimeve në institucion me përfaqësues të NJSBC dhe studentët e programit, rezulton se në përputhje me manualin e njësisë së sigurimit të cilësisë në KUW, kjo njësi përdor mekanizma formal, sic janë vetëvlerësimet e stafit akademik, rezultatet e monitorimit nga departamenti si dhe pyetësorët e studentëve të cilët, rezultuan se organizoheshin dy herë në vit, në përfundim të cdo semestri, para fillimit të sezonit të provimeve.<br>Gjithashtu, NJSBC në procedurat që ndjek analizon, përputhshmërinë e planeve mësimore dhe të syllabuseve nga pikëpamja formale më bazën ligjore në fuqi, konkretisht VKM 41, ndryshuar me VKM 879.<br>Këto më sipër, nga sa informacion siguroi GVJ, rezultojnë të përdorur në mënyrë frekuente dhe formale. |

| | |
|---|---|
| | GVJ nga sa më sipër, gjykon se institucioni përdor mekanizma të diversifikuar monitorimi dhe vlerësimi, në kuadër të metodologjisë, për të siguruar feedback-un e duhur për mbarëvajtjen e programit Master Shkencor në "Administrim Biznesi". *(Aneks 2.46.1 Model Template Pyetsori i Studenteve, Aneks 2.46 Relacion të Pyetsorit të Studenteve, Aneks 2.47 Relacion të Pyetsorit të Pedagogeve, Aneks 2.47.1 Model Template Pyetsori për Mbledhjen e Opinioneve të Pedagogut)* |
| **Kriteri 4.** Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.<br><br>**Kriteri 5.** Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë | GVJ konstaton, se rezultatet e pyetësorëve të studentëve, informacioni nga fokus grupet, nga raportet e vetëvlerësimit dhe nga monitorimet nga departamentet, dokumentohen dhe i përcillen rektoratit, drejtuesve të njësisë kryesore dhe asaj bazë, për shqyrtim të problematikave, identifikim të praktikave të mira dhe propozimin e masave për përmirësimin e cilësisë dhe adresimin e problemeve. Njësia bazë dhe ajo kryesore, analizojnë gjetjet e pyetësorëve dhe hartojnë një plan masash të nevojshëm për përmirësimin e situatës.<br><br>Nga takimet me stafin akademik, rezulton se stafit akademik në mënyrë individuale i vendosen në dispozicion, vlerësimet individuale.<br><br>*(Anex 1.15 Annual Report of University Colege Wisdom, Aneks 2.07 Raport Vjetor KUW)* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi VI.3**<br>**Institucioni i arsimit të lartë përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programit të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësia e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni i arsimit të lartë e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo vetëvlerësimeve të brendshme periodike. | Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit, rezulton se kryhet në mënyrë periodike për qëllim të akreditimit, të ndjekjes së rekomandimeve të lëna, nga akreditimet e mëparshme si dhe për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. GVJ konstaton se rolin kryesor në nivel programor për vlerësimin e kanë departamenti i Ekonomisë, përgjegjës për Masterin Shkencor në "Administrim Biznesi", për planet mësimore, për syllabuset, për cilësinë e mësimdhënies në bashkëpunim më NJSBC, që siguron informacion nga pyetësorët për lëndët e cdo program, si dhe për pedagogët e këtyre lëndëve.<br><br>*(Anex 1.15 Annual Report of University Colege Wisdom, Aneks 2.07 Raport Vjetor KUW, Aneks 2.09 Analiza Vjetore e Fakultetit te Shkencave Ekonomike dhe Shoqerore, Aneks 2.14 Analize Vjetore e Punes se Departamentit te Ekonomise, Aneks 2.55 Relacion te kalendareve te kontrollit NJSBC)* |
| **Kriteri 2.** Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit. | GVJ është e mendimit se cdo procedurë e ndjekur dhe mekanizëm i përdorur, si pyetësorët, fokus grupet, vetëvlerësimet, monitorimet nga departamenti, kontroll syllabusi, kontrolle provimesh etj, janë mekanizma monitorimi efektiv për programe studimi të natyrës ekonomike.<br><br>*(Aneks 2.46 Relacion te pyetsorit te studenteve, Aneks 2.47 Relacion te pyetsorit te pedagogeve)* |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 3.** Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitucionale apo kombëtare si provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera. | GVJ konstatoi se KUW në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimeve në "Administrim Biznesi", përdor metoda të drejtpërdrejta si:<br>- Nëpërmjet monitorimit nga departamenti, vlerëson cilësinë e mësimdhënies,<br>- Ndryshime të kurrikulës të motivuar nga ndryshimet e mjedisit apo përputhshmerinë me tregun e punës.<br>- NJSBC, organizon vlerësime të organizimit të provimeve dhe detyrave të kursit nga studentët<br>- Departamenti rezultoi se bën vëzhgime në auditor.<br>- Departamenti rezultoi se miraton rishikime të syllabuseve<br>*(Anex 1.15 Annual Report of University Colege Wisdom, Aneks 2.07 Raport Vjetor KUW, Aneks 2.46.1 Model Template Pyetsori i Studenteve, Aneks 2.46 Relacion të Pyetsorit të Studenteve, Aneks 2.47 Relacion të Pyetsorit të Pedagogeve, Aneks 2.47.1 Model Template Pyetsori për Mbledhjen e Opinioneve të Pedagogut)* |
| **Kriteri 4.** Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuara (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program | GVJ konstatoi se KUW në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit në "Administrim Biznesi", përdor përdor metoda e instrumente direkte e të tërthorta vlerësimi si:<br>- Sondazhe me studentët e programit, cdo semestër para fillimit të sezonit të provimeve<br>- Organizon fokus grupe, për tu thelluar në gjetjet ë pyetësorëve, apo për të siguruar gjetje të reja<br>- Komunikim me rrjetin Alumni<br>*(Aneks 2.46.1 Model Template Pyetsori i Studenteve, Aneks 2.46 Relacion të Pyetsorit të Studenteve)* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi VI.4**<br>**Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, stafin e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.<br>**Kriteri 2.** Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të | GVJ konstaton se KUW ka ngritur NJSBC si njësi qëndrore në nivel institucioni, që ka të sanksionuar në statutin e institucionit, detyrimin për performimin e procedurave për sigurimin e brendshëm të cilësisë.<br><br>Pavarsisht se është kjo njësi, që ka detyrë eksplicite të ndjekë dhe të monitorojë sigurimin e cilësisë, ajo e garanton këtë rol në bashkëpunim me njësinë bazë dhe atë kryesore, që janë përgjegjëse për programin e studimit. Vendimmarrjet për përmirësimin e cilësisë pas rezultateve të vlerësimit, merren dhe zbatohen kryesisht në nivel departamenti dhe njësie kryesore, sic janë rishikim planesh mësimore dhe syllabusesh, apo mbarëvajtja e mësimdhënies. |

| | |
|---|---|
| studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave. **Kriteri 3.** Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ dhe studentët e programit të studimit. **Kriteri 4.** Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve. **Kriteri 5.** Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj | Referuar takimeve me studentët dhe GVB, studentët janë të përfshirë dy herë në vit në plotësimin e pyetësorëve. Studentët e programit rezultuan gjithashtu pjesë edhe GVB dhe gjatë takimit dëshmuan për punën e realizuar.<br><br>GVJ konstatoi se edhe nëpërmjet rrjetit Alumni, institucioni siguron informacion për përmirësimin e programeve.<br><br>*GVJ nuk gjeti evidencë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë, për përfshirjen e aktorëve të jashtëm si p.sh të përfaqësuesve të Biznesit, të shoqatave të biznesit, të institucioneve publike, vendimmarrësve lokal etj. GVJ sugjeron përfshirjen e aktorëve të jashtëm, përfaqsues nga tregu i punës, përfaqësues të bizneseve, të dhomave të tregëtisë, të shoqatave të turizmit, si dhe të vendimmarrësve publik në arsim e shëndetësi, në proceset e vlerësimit dhe të përmirësimit të programit të studimit në "Administrim Biznesi".*<br><br>Pyetësorët zhvillohen fizikisht, por janë anonim, kështu ruhet anonimiteti i përgjigjeve të studentëve. Departamenti përvec analizës së problematikave të hasura në tërësi, iu vendos në dipozicion në mënyrë individuale stafeve akademike të programit, rezultatet e vlerësimeve që studentët kanë bërë për lëndët që ata mbulojnë, pas përfundimit të procesit të provimeve dhe dorëzimit të procesverbaleve.<br><br>Diskutimet zhvillohen mbi tipoogjitë e problematikave, duke shmangur diskriminimin apo pabarazinë, kundrejt stafit akademik dhe studentëve.<br><br>*(Anex 1.01 Statute of University College "Wisdom", Anex 1.06 Regulation of IQAU of University College "Wisdom", Aneks 2.46.1 Model Template Pyetsori i Studenteve, Aneks 2.46 Relacion të Pyetsorit të Studenteve, Aneks 2.47 Relacion të Pyetsorit të Pedagogeve, Aneks 2.47.1 Model Template Pyetsori për Mbledhjen e Opinioneve të Pedagogut, Vizita në institucion)* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | **X** | |

| **Standardi VI.5**<br>**Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit. **Kriteri 2.** Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale. | GVJ referuar dokumentacionit të depozituar dhe webit zyrtar të KUW, konstaton se politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.<br><br>GVJ konstatoi se KUW harton raport për sigurimin e brendshëm të cilësisë. GVJ referuar webit indentifikoi të publikuar raportet e NJSBC.<br><br>Raporti respekton lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale. Informacioni sic rezultoi nga takimet me stafin akademik, iu jepet individualisht stafeve për të respektuar të drejtën e informimit si |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 3.** Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara. | dhe për të adresuar problematikat, por njëkohësisht edhe në respekt të integritetit të secilit.<br>*(https://www.Wisdom.edu.al)* |
| **Kriteri 4.** Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit. | GVJ konstatoi se në kuadër të akreditimit periodik dhe të rekomandimeve të lëna nga bordi i Akreditimit, KUW ka hartuar një plan masash për plotësimin e tyre dhe përgjithësisht, rezulton se i ka ndjekur dhe zbatuar masat e planifikuara.<br>*ëRVB, Vizita në institucion]* |
| **Kriteri 5.** Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin e afatgjatë të cilësisë së programit të studimit | Nga takimet me përfaqësues të NJSBC dhe të stafit akademik, rezulton se stafi informohet për kalendarin e monitorimeve nga njësitë bazë, gjithashtu stafi në tërësi dhe vecanërisht ai ri, informohen në vazhdimësi për procedurat e zhvillimit të pyetësorëve, për rezultatet e tyre si dhe marrin pjesë në trajnime sidomos për familarizimin me bazën ligjore apo aktet e brendshëme rregullative, mes të cilave ato për planet mësimore, për hartim syllabusesh, për metoda innovative mësimdhënie etj, që i shërbejnë sigurimit të brendshëm të cilësisë në KUW.<br>(*Vizita në institucion)* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

## Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në "Administrim Biznesi" ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë "Kolegji Universitar Wisdom"

**Pikat e forta dhe afirmime**

1. Disponibiliteti i një infrastrukture moderne.
2. Fokusi mbi përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë.
3. Strukturë organizative efektive.
4. Bashkëpunime të reja me aktorë brenda dhe jashtë vendit.
5. Marëveshjet e shumta me bizneset dhe bankat për realizimin e praktikave mesimore dhe mundësi punësimi për studentët.

**Pika të dobta**

1. Mungesa e një fondi për kërkimim shkencor që do të stimulojë stafin dhe studentët për punë kërkimore.
2. Mungesë orientimi për studentët lidhur me të drejtën e tyre për tu përfaqësuar në Senat.
3. Mungesa e kushteve të nevojshme për pritjen e studentëve të huaj në kuadër të programeve të shkëmbimit studentor.
4. Mungesa e përfshirjes së aktorëve të jashtëm, përfaqsues nga tregu i punës, përfaqësues të bizneseve, të dhomave të tregëtisë, të shoqatave të turizmit, në proceset e vlerësimit dhe të përmirësimit të programit të studimit në "Administrim Biznesi".

**Rekomandime**

1. Rekomandohet që të krijohet një Fond për Kërkime që do të stimulonte stafin dhe studentët për punë kërkimore dhe gjithashtu te nxitet stafi dhe studentet te perfitojne nga ky fond.
2. Rekomandohet një ndërgjegjësim dhe orientim më i mirë për studentët lidhur me të drejtën e tyre për tu përfaqësuar në Senat, dhe jo vetëm të kenë një përfaqësues/senator grupi.
3. Rekomandohet që IAL të intensifikojë përpjekjet dhe të sigurojë kushtet e nevojshme për pritjen e studentëve të huaj dhe të intensifikohen përpjekjet pët të shtuar numrin e marëveshjeve dhe të shtohen mobilitetet e stafit dhe të studentëve.
4. Rekomandohet ndarja e Zyrës së Burimeve Njerëzore, Këshillimit të Karrierrës dhe Jetës Studentore në 2 zyra të vecanta, ku njëra të meret me Burimet Njerezore, rekrutimet, stafin, etj. Ndërkohë që zyra tjetër të meret me këshillimin e Karrierës dhe jetën studentore.
5. Rekomandohet përfshirja e aktorëve të jashtëm, përfaqsues nga tregu i punës, përfaqësues të bizneseve, të dhomave të tregëtisë, të shoqatave të turizmit, si dhe të vendimmarrësve publik në arsim e shëndetësi, në proceset e vlerësimit dhe të përmirësimit të programit të studimit në "Administrim Biznesi".

**Conclusions of the Evaluation of the second cycle program Master of Science in "Business Administration" offered by the Higher Education Institution "Wisdom University College"**

**Strengths and Affirmations**

1. Availability of a modern infrastructure.
2. Focus on continuous quality improvement.
3. Effective organizational structure.
4. New collaborations with domestic and foreign actors.
5. Numerous agreements with businesses and banks for the implementation of educational practices and employment opportunities for students.

**Weaknesses**

1. Lack of a scientific research fund that will stimulate staff and students for research work.
2. Lack of guidance for students regarding their right to be represented in the Senate.
3. The lack of necessary conditions for the reception of foreign students within the framework of student exchange programs.
4. The lack of involvement of external actors, representatives from the labor market, representatives of businesses, chambers of commerce, tourism associations, in the processes of evaluation and improvement of the study program in "Business Administration".

**Recommendation**

1. It is recommended to create a Research Fund that would stimulate staff and students for research work and also encourage staff and students to benefit from this fund.
2. A better awareness and orientation is recommended for students regarding their right to be represented in the Senate, and not just to have a group representative/senator.
3. It is recommended that the HEI intensify its efforts and provide the necessary conditions for the reception of foreign students and intensify its efforts to increase the number of agreements to increase the mobility of staff and students.
4. It is recommended to split the Office of Human Resources, Career Counseling and Student Life into 2 separate offices, one of which deals with Human Resources, recruitment, staff, etc. While the other office deals with career counseling and student life.
5. It is recommended to include external actors, representatives from the labor market, representatives of businesses, chambers of commerce, tourism associations, as well as public decision-makers in education and health, in the processes of evaluation and improvement of the study program in "Business Administration".

**Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit**

| FUSHAT E VLERËSIMIT | SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS | | | |
|---|---|---|---|---|
| | Nuk përmbushen | Përmbushen pjesërisht | Përmbushen kryesisht | Përmbushen plotësisht |
| I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT | | | X | |
| II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT | | | X | |
| III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT | | | | X |
| IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT | | | | X |
| V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE | | | X | |
| VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT/EVE | | | | X |
| VLERËSIMI TËRËSOR | | | X | |